



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Tiranë, më 24/06/2026

AMICUS CURIAE

OPINION

**RRETH PAJTUESHMËRISË SË LIGJIT NR. 64/2025
“PËR BARAZINË GJINORE”
ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

*Në ndihmë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
në gjykimin kushtetues mbi ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”*

Ky opinion hartohet si analizë juridike ndihmëse, e pavarur dhe e kufizuar në çështjet kushtetuese me interes publik që kërkojnë vlerësim nga Gjykata.

I

Mbi interesin dhe legjitimitetin e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri për paraqitjen e këtij Opinioni Amicus Curiae

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri paraqet këtë opinion ligjor në cilësinë e Amicus Curiae, me qëllim që t'i vijë në ndihmë Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjes që lidhet me kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”. Ndërhyrja e Qendrës nuk synon të zëvendësojë qëndrimet procedurale të palëve në gjykim dhe as të përsërisë prapësimet institucionale të paraqitura nga subjektet e interesuara, por të ofrojë një vlerësim të pavarur, profesional dhe të specializuar mbi standardet kushtetuese, ndërkombëtare dhe evropiane që duhet të udhëheqin kontrollin abstrakt të normës.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur dhe jopolitike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe adresimin e pabarazive gjinore në shoqërinë shqiptare. Ajo është themeluar me iniciativën e tri grave aktiviste të shoqërisë civile, të cilat prej më shumë se pesëmbëdhjetë vitesh kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. Qendra është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28.06.2022, si dhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë me NIPT M22002451K. Selia e saj ndodhet në Tiranë, por veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Vizioni i Qendrës është *“Të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për gratë dhe vajzat”*, ndërsa misioni i saj është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta. Ky vizion dhe mision janë të lidhur drejtpërdrejt me objektin e ligjit nr. 64/2025, i cili synon të forcojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për garantimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit dhe krijimin e kushteve për pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në jetën publike, politike, ekonomike dhe shoqërore.

Interesi i Qendrës për të paraqitur këtë opinion buron nga fusha e saj e veprimtarisë dhe nga përvoja e drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave. Qendra punon për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimin të shoqërisë rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore, si dhe për mbështetjen e grave dhe vajzave që përballen me pabarazi, diskriminim, dhunë apo pengesa sociale dhe ekonomike. Përmes programeve të fuqizimit, lidhshimit, rritjes së aftësive personale dhe profesionale, avokimit, lobimit dhe kërkimit, Qendra kontribuon në forcimin e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Në mënyrë të veçantë, veprimtaria e Qendrës përfshin adresimin e nevojave të grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe shërbimeve që synojnë fuqizimin e tyre social dhe ekonomik. Po ashtu, Qendra punon për rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve që angazhohen në mbrojtjen dhe mbështetjen e grave dhe vajzave, si dhe për zhvillimin e studimeve, analizave dhe kërkimeve mbi çështjet gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Grupet në dobi të cilave Qendra ushtron veprimtarinë e saj përfshijnë gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, gra dhe vajza që përballen me sfida sociale dhe ekonomike, të rinj dhe

të reja që studiojnë në universitete, nxënës dhe nxënëse të gjimnazeve dhe shkollave 9-vjeçare, komunitetin në tërësi, si dhe ofruesit e shërbimeve që punojnë për mbrojtjen dhe mbështetjen e grave dhe vajzave. Kjo lidhje e drejtpërdrejtë me grupet që preken nga pabarazitë gjinore dhe nga mekanizmat ligjorë të mbrojtjes e bën kontributin e Qendrës të rëndësishëm për shqyrtimin kushtetues të ligjit nr. 64/2025.

Në këtë kuptim, pjesëmarrja e Qendrës si Amicus Curiae lidhet me një interes publik të qartë: **garantimin që kontrolli kushtetues të zhvillohet mbi bazën e standardeve juridike, të praktikës ndërkombëtare dhe të realitetit shoqëror që ligji synon të adresojë.** Një ligj për barazinë gjinore nuk mund të vlerësohet vetëm në mënyrë abstrakte ose të shkëputur nga konteksti i pabarazive faktike që ai synon të korrigjojë. Ai duhet të analizohet në dritën e detyrimeve pozitive të shtetit për të garantuar barazi reale, për të parandaluar diskriminimin dhe për të mbrojtur dinjitetin e grave dhe vajzave, si dhe të të gjithë personave që preken nga stereotipet dhe pabarazitë gjinore.

Për këto arsye, Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri vlerëson se ka interes të ligjshëm, profesional dhe publik për të paraqitur këtë opinion ligjor në ndihmë të Gjykatës Kushtetuese. Ky opinion synon të kontribuojë në një interpretim të ligjit nr. 64/2025 në përputhje me Kushtetutën, me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe me standardet evropiane në fushën e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

II

Qëllimi i opinionit Amicus Curiae

Çështja paraqet rëndësi të veçantë kushtetuese, ligjore dhe shoqërore, sepse lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë kupton dhe garanton parimet themelore të barazisë, mosdiskriminimit, dinjitetit njerëzor, drejtësisë shoqërore dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut. Në qendër të këtij gjykimi nuk qëndron vetëm vlerësimi formal i një ligji të veçantë, por edhe përcaktimi i standardit kushtetues që duhet të udhëheqë shtetin shqiptar në përmbushjen e detyrimeve të tij pozitive për të adresuar pabarazitë reale dhe strukturore ndërmjet grave dhe burrave.

Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” është një ligj me natyrë horizontale, që synon të vendosë parime, mekanizma dhe detyrime institucionale për integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike, në legjislacion, në vendimmarrje, në punësim, në arsim, në media dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore. Për këtë arsye, kontrolli kushtetues ndaj tij nuk mund të kufizohet në një lexim të izoluar të disa termave të përdorur nga ligjvënësi, por duhet të mbështetet në një analizë të plotë të objektit, qëllimit, kontekstit normativ dhe efekteve reale të ligjit.

Qëllimi kryesor i këtij gjykimi është të sqarohet nëse ligjvënësi shqiptar, në ushtrim të kompetencës së tij kushtetuese, ka të drejtë të ndërtojë një kuadër ligjor bashkëkohor për barazinë gjinore, duke përdorur koncepte të njohura në të drejtën ndërkombëtare, në instrumentet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe në të drejtën e Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, çështja kërkon të përcaktohet nëse përdorimi i termave si “gjini”, “barazi gjinore”, “stereotype

gjinore”, “integrim gjinor”, “gjuhë me ndjeshmëri gjinore” apo “diskriminim i shumëfishtë” përbën cenim të Kushtetutës, apo, përkundrazi, përbën mjet të nevojshëm juridik për zbatimin efektiv të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Sipas këtij Amicus Curiae, kontrolli kushtetues nuk duhet të orientohet nga kundërshtimi abstrakt ose ideologjik ndaj terminologjisë së ligjit, por nga pyetja nëse dispozitat e tij cenojnë konkretisht ndonjë të drejtë kushtetuese, tejkalojnë kufijtë e kompetencës së ligjvënësit, krijojnë paqartësi të papajtueshme me sigurinë juridike, apo bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Vetëm një analizë e tillë i përgjigjet funksionit të Gjykatës Kushtetuese si garantuese e epërsisë së Kushtetutës dhe jo si forum për zgjidhjen e debateve politike, ideologjike apo kulturore që nuk përkthehen në cenime konkrete kushtetuese.

Në këtë kuadër, qëllimi i këtij opinioni është të ndihmojë Gjykatën në identifikimin e standardeve relevante që duhet të zbatohen në shqyrtimin e ligjit nr. 64/2025. Këto standarde përfshijnë, ndër të tjera, parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutës; detyrimin e organeve publike për të respektuar dhe kontribuar në realizimin e të drejtave dhe lirive themelore sipas nenit 15; kufijtë e lejueshëm të ndërhyrjes shtetërore sipas nenit 17; zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme sipas nenit 5; si dhe statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në rendin e brendshëm juridik sipas nenit 122 të Kushtetutës.

Gjithashtu, qëllimi i këtij opinioni është të vendosë ligjin nr. 64/2025 në kontekstin e zhvillimit të vazhdueshëm të së drejtës shqiptare për barazinë gjinore. Ky ligj nuk përfaqëson një ndërhyrje të papritur apo të shkëputur nga tradita juridike shqiptare, por vijon dhe përditëson kuadrin e mëparshëm të krijuar nga ligji nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kodi i Punës, strategjitë kombëtare për barazinë gjinore dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Për rrjedhojë, analiza kushtetuese duhet të shmangë një qasje të fragmentuar dhe duhet ta lexojë ligjin si pjesë të një sistemi më të gjerë normativ që synon mbrojtjen efektive të barazisë.

Një tjetër qëllim i rëndësishëm i këtij opinioni është të sqarojë se ligji për barazinë gjinore nuk krijon kategori të reja të statusit civil, nuk ndryshon konceptet e Kodit të Familjes, nuk ndërhyr në regjistrat e gjendjes civile dhe nuk zëvendëson kuptimet juridike që përdoren në fusha të tjera normative. Ai përdor terminologjinë e barazisë gjinore në funksion të objektit të vet: identifikimin, parandalimin dhe korrigjimin e pabarazive që burojnë nga rolet, stereotipet dhe barrierat strukturore që prekin gratë dhe burrat në jetën shoqërore, ekonomike, politike dhe institucionale.

Në këtë drejtim, çështja kërkon të sqarohet nëse një ligj horizontal për barazinë gjinore, i cili përdor terma të njohur në Konventën CEDAW, Konventën e Stambollit, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtën e Bashkimit Evropian dhe dokumentet e institucioneve ndërkombëtare, mund të konsiderohet antikushtetues vetëm për shkak të kundërshtimit ideologjik ndaj terminologjisë së tij. Për arsytet që shtjellohen në vijim, ky Amicus Curiae çmon se përgjigjja duhet të jetë negative.

Pranimi i një teze të kundërt do të krijonte një standard të rrezikshëm për kontrollin kushtetues: çdo ligj që përdor koncepte bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare ose evropiane mund të vihej në dyshim jo për shkak të cenimit real të të drejtave, por për shkak të debatit politik ose kulturor që shoqëron terminologjinë e tij. Një qasje e tillë do ta dobësonte funksionin racional të kontrollit kushtetues dhe do të kufizonte aftësinë e ligjvënësit për të përmbushur detyrimet pozitive të shtetit në fusha ku pabarazitë janë të dokumentuara dhe kërkojnë ndërhyrje normative.

Për këtë arsye, ky opinion mbështetet në premisën se Gjykata Kushtetuese duhet ta vlerësojë ligjin nr. 64/2025 në dritën e qëllimit të tij legjitim: garantimin e barazisë reale ndërmjet grave dhe burrave, parandalimin e diskriminimit, forcimin e mekanizmave institucionalë, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me standardet evropiane. Në këtë kuptim, ligji nuk duhet parë si kufizim i lirive kushtetuese, por si instrument për realizimin efektiv të tyre.

Sa më sipër, qëllimi i këtij *Amicus Curiae* është të ofrojë një analizë të pavarur dhe të specializuar që ndihmon Gjykatën të dallojë midis debatit ideologjik mbi gjuhën e përdorur në ligj dhe kontrollit juridik të kushtetutshmërisë së normës. Nga kjo perspektivë, ligji nr. 64/2025 nuk paraqet cenim të Kushtetutës, por përfaqëson një ushtrim të ligjshëm të kompetencës së Kuvendit për të ndërtuar mekanizma efektivë të barazisë, në përputhje me vlerat kushtetuese, detyrimet ndërkombëtare dhe orientimin evropian të Republikës së Shqipërisë.

III

Përmbledhje e qëndrimit juridik

Ky *Amicus Curiae* vlerëson se ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nuk bie ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Përkundrazi, ligji përfaqëson një zhvillim të natyrshëm dhe të nevojshëm të kuadrit ekzistues ligjor për barazinë gjinore, duke përditësuar ligjin nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe duke e përafruar më tej rendin juridik shqiptar me standardet e CEDAW, Konventës së Stambollit, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe *acquis* të Bashkimit Evropian.

Në thelb, ligji nr. 64/2025 nuk krijon një regjim të ri juridik jashtë rendit kushtetues, nuk ndryshon statusin civil të personit, nuk ndërhyr në institutin e martesës ose të familjes dhe nuk cenon lirinë e shprehjes apo lirinë e medias. Ai vendos një kornizë horizontale për realizimin efektiv të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, për parandalimin e diskriminimit dhe për eliminimin e stereotipeve gjinore në politikat publike, institucionet dhe komunikimin publik.

Në mënyrë të përmbledhur, qëndrimi juridik i këtij *Amicus Curiae* mbështetet në këto argumente kryesore:

- **Ligji konkretizon nenin 18 të Kushtetutës**, sepse e trajton barazinë jo vetëm si barazi formale para ligjit, por edhe si barazi reale në jetën shoqërore, ekonomike, politike dhe institucionale. Kushtetuta nuk kërkon vetëm ndalim abstrakt të diskriminimit, por edhe masa që bëjnë të mundur gëzimin efektiv të të drejtave.

- **Ligji është në përputhje me nenin 3 të Kushtetutës**, pasi i jep përmbajtje konkrete dinjitetit njerëzor, të drejtave dhe lirive themelore, drejtësisë shoqërore dhe rendit kushtetues. Ai synon të adresojë pabarazi reale që kufizojnë autonominë dhe mundësitë e individëve, veçanërisht të grave dhe vajzave.
- **Termi “gjini” nuk është koncept i ri ose i panjohur për rendin juridik shqiptar.** Ai është përdorur më parë në ligjin nr. 9970/2008 dhe në instrumente ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, veçanërisht në Konventën e Stambollit. Në ligjin nr. 64/2025, ky term përdoret në kuptim funksional, për të identifikuar rolet, stereotipet dhe pengesat shoqërore që prodhojnë pabarazi ndërmjet grave dhe burrave.
- **Ligji nuk krijon konflikt me legjislacionin sektorial.** Ai nuk ndryshon Kodin e Familjes, ligjin për gjendjen civile, Kodin Civil, Kodin Penal ose Kodin e Punës. Ligji vepron në një fushë tjetër rregullimi: barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe politikat publike. Për këtë arsye, termit e tij duhet të interpretohen brenda objektit të tij dhe jo si ndërhyrje në regjimet juridike sektoriale.
- **Ligji nuk cenon nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës.** Ai nuk prek institutin e martesës, familjes, prindërisë ose statusin juridik të fëmijës. Përkundrazi, masat për barazi gjinore, ndarje më të drejtë të përgjegjësisë familjare, mbrojtje nga stereotipet dhe mosdiskriminim janë në harmoni me mbrojtjen kushtetuese të familjes, fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja.
- **Detyrimet për gjuhë me ndjeshmëri gjinore dhe komunikim jo-diskriminues nuk përbëjnë censurë.** Ato janë standarde të ligjshme, të arsyeshme dhe proporcionale për komunikimin institucional, administratën publike dhe subjektet që ofrojnë shërbime me interes publik. Ligji nuk ndalon opinione, nuk kriminalizon mendime dhe nuk vendos kontroll paraprak mbi debatin publik ose mediatik.
- **Ligji është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare dhe standardet evropiane.** CEDAW kërkon eliminimin e stereotipeve dhe modeleve shoqërore që prodhojnë pabarazi; Konventa e Stambollit njeh shprehimisht konceptin e “gjinisë” si rol dhe atribut shoqëror; ndërsa *acquis* i Bashkimit Evropian kërkon masa konkrete për barazinë në punësim, transparencën e pagave, balancën punë-jetë, përfaqësimin në vendimmarrje dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.
- **Pezullimi i zbatimit të ligjit nuk justifikohet.** Nuk rezulton një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm që të kërkojë ndërprerjen e efekteve të ligjit deri në vendimin përfundimtar. Përkundrazi, pezullimi do të krijonte boshllëk institucional, do të vononte zbatimin e mekanizmave të barazisë dhe do të dobësonte përmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit.

Për këto arsye, ky *Amicus Curiae* vlerëson se kërkesa për shfuqizimin e ligjit nr. 64/2025 duhet të rrëzohet si e pabazuar. Ligji duhet të lexohet si instrument për realizimin efektiv të barazisë, dinjitetit njerëzor dhe mosdiskriminimit, dhe jo si akt që cenon rendin kushtetues.

Nëse Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme, ajo mund të sqarojë në arsyetimin e saj se përkufizimet dhe detyrimet e ligjit nr. 64/2025 interpretohen në mënyrë funksionale dhe sistematike, brenda objektit të ligjit: promovimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, eliminimit të stereotipeve gjinore, parandalimit të diskriminimit dhe përmbushjes së detyrimeve kushtetuese, ndërkombëtare dhe evropiane të Republikës së Shqipërisë.

III

Korniza kushtetuese: barazia, dinjiteti, drejtësia shoqërore dhe mbrojtja e familjes e fëmijëve

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” duhet të nisët nga një lexim sistematik i Kushtetutës dhe jo nga një interpretim i izoluar i termave të përdorur në ligj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk e koncepton barazinë si një parim formal dhe statik, por si një garanci materiale që kërkon nga shteti të ndërmarrë masa për të parandaluar diskriminimin, për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për të krijuar kushte reale për gëzimin efektiv të të drejtave.

Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 duhet të analizohet në dritën e disa dispozitave themelore kushtetuese që ndërveprojnë me njëra-tjetrën: neni 3, që përcakton dinjitetin njerëzor, të drejtat dhe liritë themelore, drejtësinë shoqërore dhe rendin kushtetues si baza të shtetit; neni 18, që sanksionon barazinë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit; neni 15, që vendos detyrimin e organeve publike për të respektuar dhe kontribuar në realizimin e të drejtave themelore; neni 17, që përcakton standardin e kufizimeve të lejueshme të të drejtave; neni 5 dhe neni 122, që lidhin rendin e brendshëm juridik me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme; si dhe nenet 53 dhe 54, që mbrojnë familjen, martesën dhe fëmijët.

Ky lexim sistematik është i rëndësishëm sepse pretendimet kundër ligjit nr. 64/2025 në thelb synojnë ta shkëpusin terminologjinë e ligjit nga funksioni i saj juridik. Një qasje e tillë nuk i përgjigjet metodës kushtetuese të interpretimit. Një ligj horizontal për barazinë gjinore nuk duhet vlerësuar duke izoluar një term nga konteksti, por duke analizuar qëllimin e ligjit, fushën e zbatimit, efektet normative dhe marrëdhënien e tij me të drejtat kushtetuese që synon të bëjë efektive.

- Neni 18 i Kushtetutës dhe barazia si parim substancial

Neni 18 i Kushtetutës sanksionon barazinë e të gjithëve para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit të padrejtë për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në mënyrë të ngushtë, vetëm si ndalim i trajtimit të ndryshëm formal. Në një rend kushtetues demokratik, barazia nuk nënkupton thjesht trajtim identik të të gjithë personave, pavarësisht kushteve të tyre konkrete, por kërkon që shteti të njohë dhe të adresojë pengesat reale që e bëjnë barazinë formale të pamjaftueshme në praktikë.

Nëse dy persona ose dy kategori personash trajtohen në mënyrë identike nga ligji, por njëra prej tyre përballë në realitet me pengesa strukturore, stereotipe, diskriminim të shumëfishtë ose përjashtim sistematik nga mundësitë ekonomike, shoqërore apo institucionale, atëherë trajtimi i

njëjtë nuk garanton domosdoshmërisht barazi reale. Për këtë arsye, neni 18 duhet lexuar si një normë që jo vetëm ndalon diskriminimin e padrejtë, por edhe lejon, dhe në raste të caktuara kërkon, masa pozitive të shtetit për të korrigjuar pabarazitë faktike.

Ligji nr. 64/2025 është pikërisht një instrument i tillë. Ai nuk krijon privilegje arbitrare dhe as nuk vendos trajtim të pajustificuar në favor të një grupi kundrejt një tjetri. Përkundrazi, ai synon të krijojë mekanizma për identifikimin, parandalimin dhe korrigjimin e pabarazive gjinore që shfaqen në punësim, arsim, përfaqësim, vendimmarrje, media, shërbime publike dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore. Në këtë kuptim, ligji nuk bie ndesh me nenin 18 të Kushtetutës, por e konkretizon atë në një fushë ku pabarazitë janë të dokumentuara dhe kanë karakter strukturor.

Një interpretim që do ta kufizonte nenin 18 vetëm në trajtim identik formal do ta zbrazte këtë dispozitë nga funksioni i saj mbrojtës. Kushtetuta nuk garanton një barazi abstrakte dhe deklarative, por një barazi efektive, të aftë të prodhojë mbrojtje reale për individët dhe grupet që përballen me disavantazhe. Për këtë arsye, përdorimi në ligj i koncepteve si “barazi gjinore”, “integrim gjinor”, “stereotipe gjinore” ose “diskriminim i shumëfishtë” nuk përbën cenim të Kushtetutës, por një mjet juridik për zbatimin efektiv të saj.

Ky kuptim substancial i barazisë është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në lidhje me të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në raport me të drejtat e tjera ligjore. Megjithatë, barazia në ligj dhe para ligjit nuk nënkupton detyrimisht zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme. Sipas Gjykatës Kushtetuese, ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta, ndërsa trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore, për shkaqe të arsyeshme dhe objektive (GJK, vendim nr. 31/2021, para. 47).

Në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se organi ligjvënës është i detyruar t’i përmbahet parimit të barazisë kur bëhet fjalë për “barazinë në ligj”. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata shqyrton fillimisht nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve. Nëse një trajtim i tillë konstatohet, Gjykata vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur nga një arsye objektive dhe e arsyeshme. Kjo përligjje lidhet me qëllimet dhe efektet e masave të marra nga ligjvënësi (GJK, vendim nr. 31/2021, para. 47).

Gjithashtu, jurisprudenca kushtetuese ka sqaruar se nuk mjafton vetëm ekzistenca e një arsyeje të përligjur për trajtim të diferencuar; mjeti i zgjedhur nga ligjvënësi për arritjen e qëllimit duhet të jetë i arsyeshëm, i përshtatshëm dhe proporcional. Ky standard është konfirmuar në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, ku është theksuar se dallimi në trajtim duhet të ketë lidhje të arsyeshme me qëllimin që synohet të arrihet dhe të mos krijojë pasoja të pajustificuara për subjektet e prekura (shih vendimet nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk ndalon çdo trajtim të diferencuar. Përkundrazi, në raste të caktuara ai mund të kërkojë pikërisht trajtim të ndryshëm për subjekte që ndodhen në situata faktike të ndryshme. Gjykata Kushtetuese ka pranuar se, kur subjektet paraqesin specifika faktike

të ndryshme, trajtimi i njëjtë mund të jetë po aq problematik sa trajtimi i ndryshëm i pajustificuar. Për këtë arsye, në rastet kur ligji trajton në mënyrë të njëjtë subjekte që ndodhen në kushte të ndryshme, Gjykata shqyrton nëse ligjvënësi duhej të kishte parashikuar diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive (shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme për çështjen në shqyrtim. Pabarazitë gjinore nuk shfaqen gjithmonë si ndalime të drejtpërdrejta ligjore ndaj grave ose burrave, por shpesh si barriera strukturore, stereotipe, ndarje e pabarabartë e përgjegjësive familjare, përfaqësim i ulët në vendimmarrje, hendek në paga, akses i pabarabartë në burime ose ekspozim më i madh ndaj dhunës dhe diskriminimit. Në këto rrethana, barazia substanciale kërkon që ligjvënësi të ndërtojë mekanizma të posaçëm për të identifikuar dhe korrigjuar këto pengesa.

Në vendimin nr. 48/2013, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës si garanci për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një gamë të gjerë shkaqesh, duke përfshirë gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose çdo shkak tjetër. Kjo tregon se mbrojtja kushtetuese kundër diskriminimit ka karakter të hapur dhe dinamik, duke u përshtatur me format e ndryshme në të cilat pabarazia mund të shfaqet në shoqëri.

Po në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese i është referuar edhe ligjit shqiptar “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke theksuar se parimi i barazisë nënkupton: së pari, barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; së dyti, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; dhe së treti, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin (shih vendimin nr. 48/2013 të Gjykatës Kushtetuese, para. 15–16).

Ky standard është drejtpërdrejt i zbatueshëm në vlerësimin e ligjit nr. 64/2025. Ligji nuk synon të krijojë dallime artificiale ose privilegje të pajustificuara, por të garantojë barazi të shanseve dhe mundësive, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe pjesëmarrje më të barabartë në jetën publike. Këto janë elementë që vetë jurisprudenca kushtetuese i ka njohur si pjesë të përmbajtjes së parimit të barazisë.

Për rrjedhojë, ligji nr. 64/2025 duhet të lexohet si një instrument për realizimin substancial të nenit 18 të Kushtetutës. Ai nuk zëvendëson parimin e barazisë me një regjim privilegjesh, por përpaket të bëjë të zbatueshme në praktikë atë që Kushtetuta garanton në nivel normativ: barazi reale, mosdiskriminim dhe mbrojtje efektive përballë pengesave që kufizojnë gëzimin e të drejtave. Në këtë kuptim, pretendimi se ligji bie ndesh me nenin 18 është i pabazuar, pasi ligji jo vetëm që nuk e cenon këtë dispozitë, por shërben si mjet për zbatimin e saj.

- Neni 3 i Kushtetutës: dinjiteti njerëzor dhe drejtësia shoqërore

Neni 3 i Kushtetutës përcakton ndër bazat themelore të shtetit shqiptar dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë themelore, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar dhe

bashkëjetesën fetare. Kjo dispozitë ka rëndësi të posaçme në vlerësimin e ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, sepse vendos kornizën aksiologjike mbi të cilën duhet të interpretohen të gjitha të drejtat, liritë dhe detyrimet kushtetuese. Vlerat e nenit 3 nuk janë deklarata politike pa efekt normativ; ato janë parime themelore orientuese për ligjvënësin, administratën publike dhe gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese në ushtrimin e kontrollit abstrakt të normës.

Në këtë kuptim, çdo analizë mbi barazinë gjinore duhet të fillojë nga fakti se Kushtetuta nuk mbron vetëm ekzistencën formale të të drejtave, por kërkon që ato të jenë reale, efektive dhe të ushtrueshme në praktikë. Dinjiteti njerëzor, si bazë e shtetit, nënkupton se çdo person duhet të trajtohet si subjekt i barabartë i së drejtës, me mundësi reale për të zhvilluar jetën personale, familjare, profesionale dhe shoqërore pa u kufizuar nga stereotipe, paragjykime apo barriera të padrejta. Për rrjedhojë, shteti nuk e përmbush detyrimin e tij kushtetues nëse mjaftohet vetëm me mosndërrhyrje formale, ndërkohë që në realitet grupe të caktuara, përfshirë gratë dhe vajzat, përballen me pengesa strukturore në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Dinjiteti njerëzor nuk mbrohet duke mohuar ekzistencën e pabarazive shoqërore, por duke i njohur dhe adresuar ato përmes instrumenteve ligjore të arsyeshme. Kur një grua përjashtohet ose dekurajohet nga profesione të caktuara për shkak të stereotipeve mbi “punët e grave” dhe “punët e burrave”; kur barra e kujdesit familjar dhe punës së papaguar bie në mënyrë disproporcionale mbi gratë dhe i largon ato nga tregu i punës; kur gratë penalizohen në karrierë për shkak të shtatzënisë, amësisë ose përgjegjësisë familjare; kur dhuna me bazë gjinore kufizon lirinë, sigurinë dhe autonominë e tyre; ose kur përfaqësimi në vendimmarrje mbetet sistematikisht i pabalancuar, nuk kemi thjesht probleme sociale të shkëputura nga Kushtetuta. Kemi situata që prekin drejtpërdrejt dinjitetin, barazinë dhe mundësinë reale për gëzimin e të drejtave themelore.

Në këto kushte, neutraliteti pasiv i shtetit nuk është i mjaftueshëm. Një rend kushtetues që vendos dinjitetin njerëzor dhe drejtësinë shoqërore ndër bazat e tij kërkon nga shteti jo vetëm të mos diskriminojë, por edhe të ndërtojë mekanizma që parandalojnë dhe korrigjojnë diskriminimin. Kjo përfshin detyrimin për të krijuar institucione, politika, procedura dhe standarde që e bëjnë barazinë të zbatueshme në praktikë. Ligji nr. 64/2025 duhet parë pikërisht në këtë dritë: si një instrument që synon të kalojë nga barazia formale drejt barazisë reale, duke i dhënë përmbajtje konkrete parimeve të nenit 3 dhe nenit 18 të Kushtetutës.

Drejtësia shoqërore, si vlerë kushtetuese, ka po ashtu një funksion të rëndësishëm në këtë analizë. Ajo nuk mund të kuptohet vetëm si objektiv i përgjithshëm politik, por si kriter kushtetues që i kërkon shtetit të ndërhyjë për të zvogëluar pabarazitë e pajustificuara dhe për të krijuar kushte të barabarta për pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike. Në fushën e barazisë gjinore, drejtësia shoqërore kërkon që ligjvënësi të adresojë ato forma pabarazie që nuk zhduken vetvetiu nga shpallja abstrakte e barazisë para ligjit.

Këto pabarazi mund të jenë historike, institucionale, ekonomike, kulturore ose të lidhura me rolet tradicionale gjinore. Ato shfaqen në hendekun gjinor në paga, në përfaqësimin e ulët të grave në pozicione drejtuese, në ndarjen e pabarabartë të punës së papaguar dhe kujdesit familjar, në ekspozimin më të lartë të grave dhe vajzave ndaj dhunës me bazë gjinore, në stereotipet në arsim dhe media, si dhe në pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën publike. Një ligj

që synon të identifikojë dhe të korrigjojë këto pabarazi nuk bie ndesh me drejtësinë shoqërore; përkundrazi, është shprehje e saj.

Në të njëjtën kohë, barazia gjinore nuk është një projekt që u shërben vetëm grave dhe vajzave. Ajo është e lidhur me dinjitetin dhe lirinë e çdo personi. Stereotipet gjinore kufizojnë edhe burrat dhe djemtë, kur u imponojnë modele të ngurta sjelljeje, i dekurajojnë nga roli aktiv prindëror, nga përfshirja në kujdes, nga shprehja e nevojave emocionale ose nga zgjedhje profesionale e shoqërore që konsiderohen jashtë roleve tradicionale. Për këtë arsye, një ligj për barazinë gjinore nuk krijon konflikt ndërmjet grave dhe burrave, por synon të ndërtojë kushte më të drejta për të dyja gjinitë, duke çliruar individin nga pritshmëritë e ngurta që kufizojnë autonominë e tij.

Në këtë kuptim, pretendimi se ligji nr. 64/2025 cenon rendin kushtetues për shkak se përdor koncepte të tilla si “gjini”, “stereotipe gjinore” ose “integrim gjinor” nuk qëndron. Përkundrazi, këto koncepte janë mjete juridike dhe analitike për të kuptuar se si pabarazitë prodhohen dhe riprodhohen në praktikë. Pa këto koncepte, shteti do të kishte më pak mundësi të identifikonte pengesat reale që cenojnë dinjitetin dhe barazinë. Kushtetuta nuk e ndalon ligjvënësinë të përdorë terminologji bashkëkohore për të realizuar qëllime kushtetuese; ajo kërkon që mjetet e zgjedhura të jenë të arsyeshme, të qarta dhe në përputhje me të drejtat themelore.

Ligji nr. 64/2025 nuk përmbys rendin kushtetues, nuk cenon thelbin e të drejtave dhe nuk krijon një regjim të ri juridik që bie ndesh me vlerat themelore të Kushtetutës. Përkundrazi, ai përpiket të përkthejë në mekanizma ligjorë ato vlera që neni 3 i vendos në themel të shtetit: dinjitetin njerëzor, barazinë, mbrojtjen e të drejtave dhe drejtësinë shoqërore. Ai synon të krijojë një kuadër institucional që ndihmon administratën, institucionet publike dhe subjektet e tjera të kuptojnë dhe të adresojnë pabarazitë gjinore në mënyrë sistematike.

Gjithashtu, rendi kushtetues nuk mbrohet duke ruajtur gjendjen ekzistuese të pabarazisë, por duke siguruar që ligjvënësi të veprojë brenda kufijve të Kushtetutës për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave. Nëse Kushtetuta e vendos dinjitetin njerëzor dhe drejtësinë shoqërore si baza të shtetit, atëherë ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por edhe detyrim të ndërmarrë masa që synojnë realizimin efektiv të këtyre vlerave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fusha ku pabarazitë janë të dokumentuara, të përsëritura dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në gëzimin e të drejtave.

Për rrjedhojë, ligji nr. 64/2025 duhet kuptuar si pjesë e detyrimit kushtetues të shtetit për të krijuar kushte reale barazie dhe për të mbrojtur dinjitetin e çdo personi. Ai nuk vendos privilegje arbitrarë, nuk mohon dallimet biologjike dhe nuk ndërhyr në identitetin personal apo familjar të individëve. Ai adreson rolet, stereotipet dhe barrierat sociale që mund të prodhojnë diskriminim dhe pabarazi. Në këtë kuptim, ligji nuk cenon nenin 3 të Kushtetutës, por i jep atij përmbajtje konkrete në fushën e barazisë gjinore.

Bazuar në arsyetimin më lart, neni 3 i Kushtetutës mbështet, dhe jo kundërshton, ekzistencën e një ligji horizontal për barazinë gjinore. Dinjiteti njerëzor kërkon që individët të mos kufizohen nga role të imponuara dhe diskriminim strukturor. Drejtësia shoqërore kërkon që shteti të ndërhyjë për të korrigjuar pabarazitë reale. Rendi kushtetues kërkon që të drejtat të jenë efektive dhe jo thjesht të deklaruara. Nga kjo perspektivë, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me bazat kushtetuese të shtetit shqiptar dhe duhet vlerësuar si instrument për forcimin, jo cenimin, e tyre.

- Detyrimet pozitive të shtetit sipas neneve 15, 17, 5 dhe 122 të Kushtetutës

Neni 15 i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, si dhe se ato qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Po kjo dispozitë parashikon se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t'i respektojnë të drejtat dhe liritë themelore, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ky formulim ka rëndësi thelbësore për çështjen në shqyrtim, pasi Kushtetuta nuk e koncepton shtetin vetëm si subjekt që duhet të përmbahet nga cenimi i të drejtave, por edhe si garant aktiv i kushteve që i bëjnë këto të drejta reale dhe efektive.

Në këtë kuptim, detyrimi kushtetues i shtetit nuk mbaron me shpalljen formale të barazisë para ligjit. Nëse në realitetin shoqëror ekzistojnë pengesa strukturore që kufizojnë gëzimin e barabartë të të drejtave nga gratë dhe burrat, shteti nuk mund të qëndrojë pasiv me argumentin se ligji i trajton të gjithë njësoj. Një qasje e tillë do ta reduktonte barazinë në një garanci abstrakte dhe do ta bënte të pamundur korrigjimin e pabarazive që lindin jo domosdoshmërisht nga teksti i ligjit, por nga mënyra se si shoqëria, institucionet dhe praktikrat publike funksionojnë në realitet.

Pikërisht për këtë arsye, neni 15 duhet lexuar në lidhje të ngushtë me nenin 18 të Kushtetutës. Ndërsa neni 18 ndalon diskriminimin dhe garanton barazinë para ligjit, neni 15 i jep këtij parimi dimensionin e tij aktiv: organet publike duhet jo vetëm të mos diskriminojnë, por edhe të kontribuojnë në realizimin e barazisë. Në fushën e barazisë gjinore, kjo do të thotë se shteti ka detyrim të ndërmarrë masa ligjore, institucionale, administrative, arsimore dhe programore për të identifikuar, parandaluar dhe korrigjuar pabarazitë që prekin gratë, vajzat, burrat dhe djemtë në mënyra të ndryshme.

Ligji nr. 64/2025 është ndërtuar pikërisht mbi këtë logjikë kushtetuese. Ai nuk synon vetëm të shpallë parimin e barazisë gjinore, por të krijojë instrumente konkrete për zbatimin e tij: integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike, forcimin e mekanizmave institucionale, parandalimin e stereotipeve, përmirësimin e përfaqësimit, përdorimin e të dhënave dhe masave të posaçme aty ku pabarazitë e kërkojnë. Këto mekanizma janë shprehje e detyrimit pozitiv të shtetit për të kontribuar në realizimin e të drejtave, dhe jo tejkalim i kompetencave të tij.

Në këtë kontekst duhet analizuar edhe neni 17 i Kushtetutës. Kjo dispozitë ka rëndësi në rastet kur pretendohet se një ligj kufizon të drejta dhe liri themelore. Sipas nenit 17, kufizimet e të drejtave mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, dhe duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar. Gjithashtu, këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe nëse disa dispozita të ligjit nr. 64/2025 do të lexoheshin si ndërhyrje në mënyrën e organizimit institucional, në komunikimin publik, në hartimin e politikave, në raportimin institucional ose në standardet e administratës publike, ato përmbushin kriteret e nenit 17. Së pari, ato janë të parashikuara me ligj. Së dyti, ndjekin një qëllim legjitim: mbrojtjen e barazisë, dinjitetit njerëzor, mosdiskriminimit dhe të drejtave të të tjerëve. Së treti, janë masa të natyrës administrative, institucionale dhe programore, të cilat nuk cenojnë thelbin e asnjë të drejte kushtetuese.

Për më tepër, masat e parashikuara nga ligji janë proporcionale me qëllimin që ndjekin. Ato nuk vendosin ndalime të përgjithshme mbi lirinë e shprehjes, nuk cenojnë lirinë e ndërgjegjes, nuk ndërhyjnë në jetën private, nuk ndryshojnë regjimin juridik të familjes apo martesës dhe nuk vendosin detyrime arbitrare mbi individët. Ato synojnë të udhëzojnë, organizojnë dhe orientojnë institucionet publike dhe subjektet përgjegjëse drejt një mënyre më efektive të garantimit të barazisë gjinore. Për rrjedhojë, edhe në rast se do të konsiderohej se ligji krijon ndërhyrje në disa fusha të veprimtarisë publike, kjo ndërhyrje është e justifikuar, e arsyeshme dhe në përputhje me testin kushtetues të proporcionalitetit.

Neni 17 është veçanërisht i rëndësishëm edhe për të dalluar ndërmjet kufizimit të një të drejte dhe rregullimit të mënyrës së ushtrimit të funksioneve publike. Jo çdo standard i vendosur nga ligji për administratën, institucionet publike, politikat shtetërore apo komunikimin institucional përbën kufizim të të drejtave themelore. Në rastin konkret, ligji nr. 64/2025 nuk ndalon mendime, nuk sanksionon bindje, nuk imponon një ideologji të detyrueshme për qytetarët dhe nuk penalizon debatin publik. Ai vendos standarde të arsyeshme për mënyrën se si shteti duhet të përmbushë detyrimin e tij për barazi dhe mosdiskriminim.

Po kështu, neni 5 i Kushtetutës përcakton se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Kjo dispozitë vendos një parim themelor të hapjes së rendit kushtetues shqiptar ndaj standardeve ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut. Në një shtet që ka pranuar detyrime ndërkombëtare për barazinë gjinore, mosdiskriminimin, parandalimin e dhunës ndaj grave dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, ligjvënësi ka jo vetëm të drejtë, por edhe detyrim të përafrojë legjislacionin e brendshëm me këto standarde.

Ky detyrim përforcohet nga neni 122 i Kushtetutës, sipas të cilit marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pasi botohen në Fletoren Zyrtare, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohen drejtpërdrejt, përveç rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe kërkojnë nxjerrjen e një ligji. Po kjo dispozitë parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to. Për rrjedhojë, kontrolli kushtetues i ligjit nr. 64/2025 nuk mund të bëhet duke injoruar instrumentet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë kanë Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventa e Stambollit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Këto instrumente nuk e trajtojnë barazinë gjinore si një aspiratë politike, por si detyrim juridik të shteteve për të marrë masa efektive kundër diskriminimit, stereotipeve, dhunës dhe pabarazive strukturore.

Konventa CEDAW, në veçanti, kërkon nga shtetet jo vetëm të ndalojnë diskriminimin ndaj grave në ligj, por edhe të ndërmarrin masa për të ndryshuar modelet shoqërore dhe kulturore që mbështesin inferioritetin ose superioritetin e njëres gjini, ose rolet stereotipike të grave dhe burrave. Ky detyrim është i lidhur drejtpërdrejt me logjikën e ligjit nr. 64/2025, i cili përdor koncepte të tilla si stereotipet gjinore, integrimi gjinor dhe masat për barazi efektive. Këto nuk janë koncepte të huaja për Kushtetutën, por instrumente për zbatimin e detyrimeve që Shqipëria ka pranuar në nivel ndërkombëtar.

Po kështu, Konventa e Stambollit përdor shprehimisht konceptin e “gjinisë” si role, sjellje, aktivitete dhe attribute të ndërtuara shoqërisht, që një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat. Përderisa kjo konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe është pjesë e rendit të brendshëm juridik, pretendimi se përdorimi i këtij koncepti në ligjin nr. 64/2025 është në vetvete antikushtetues nuk qëndron. Përkundrazi, përdorimi i tij është në përputhje me detyrimin kushtetues për të harmonizuar të drejtën e brendshme me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara.

Në këtë kuadër, ligji nr. 64/2025 duhet parë si akt i përmbushjes së detyrimeve pozitive të shtetit në tri nivele: së pari, në nivel kushtetues, si instrument për realizimin e neneve 3, 15 dhe 18; së dyti, në nivel ndërkombëtar, si mjet për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga konventat e ratifikuara; dhe së treti, në nivel evropian, si hap në drejtim të përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian për barazinë gjinore, mosdiskriminimin, transparencën, pjesëmarrjen dhe mbrojtjen nga dhuna e pabarazitë strukturore.

Prandaj, pretendimi se ligji nr. 64/2025 është i papajtueshëm me Kushtetutën për shkak të terminologjisë apo mekanizmave që përdor nuk mund të pranohet pa një analizë të detyrimeve pozitive që vetë Kushtetuta i vendos shtetit. Kushtetuta nuk është neutrale ndaj pabarazisë; ajo kërkon mbrojtje efektive të të drejtave, respektim të dinjitetit njerëzor, ndalim të diskriminimit dhe zbatim të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme. Ligji i kundërshtuar vepron brenda kësaj kornize.

Për rrjedhojë, nenet 15, 17, 5 dhe 122 të Kushtetutës nuk mbështesin kërkesën për shfuqizimin e ligjit nr. 64/2025. Përkundrazi, ato mbështesin nevojën për një ligj të tillë. Neni 15 kërkon realizimin efektiv të të drejtave; neni 17 lejon masa të arsyeshme dhe proporcionale për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe interesit publik; neni 5 kërkon zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme; ndërsa neni 122 i jep marrëveshjeve të ratifikuara vend të posaçëm në rendin juridik të brendshëm. Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me Kushtetutën dhe përbën ushtrim të ligjshëm të detyrimit të shtetit për të garantuar barazi reale dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

- Ligji nr. 64/2025 si instrument që forcon mbrojtjen ndaj familjes dhe fëmijëve në kuptim të neneve 53 dhe 54 të Kushtetutës

Neni 53 i Kushtetutës parashikon se “kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje” dhe se “martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit”. Kjo dispozitë ka funksion garantues dhe mbrojtës. Ajo vendos detyrimin e shtetit për të respektuar lirinë e individit për të krijuar familje, për të mbrojtur institucionin e martesës dhe për të mbështetur familjen si njësi themelore e jetës shoqërore.

Në këtë kuptim, neni 53 nuk duhet lexuar si një normë që e kufizon ligjvënësin në miratimin e politikave të barazisë gjinore, por si një dispozitë që kërkon nga shteti të krijojë kushte reale që jeta familjare të zhvillohet mbi bazën e dinjitetit, barazisë, përgjegjësisë së përbashkët dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Familja nuk mbrohet vetëm përmes ruajtjes formale të statusit të saj juridik, por edhe përmes masave që sigurojnë që brenda dhe rreth saj të mos riprodhohen pabarazi, dhunë, varësi ekonomike ose role të imponuara që cenojnë dinjitetin e anëtarëve të saj.

Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” nuk ndryshon regjimin juridik të familjes apo të martesës. Ai nuk ndërhyt në Kodin e Familjes, nuk modifikon kushtet e lidhjes së martesës, nuk prek të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore, nuk ndryshon rregullat mbi prindërinë, kujdestarinë, përgjegjësinë prindërore, regjistrimin civil ose statusin juridik të fëmijës. Për rrjedhojë, nga pikëpamja normative, nuk ekziston konflikt ndërmjet ligjit nr. 64/2025 dhe nenit 53 të Kushtetutës.

Objekti i ligjit nr. 64/2025 është i ndryshëm nga objekti i legjislacionit familjar. Ai nuk rregullon themelimin, organizimin ose zgjidhjen e marrëdhënieve familjare. Ai synon të garantojë barazinë gjinore në shoqëri, të parandalojë diskriminimin dhe të krijojë mekanizma institucionalë për integrimin e perspektivës gjinore në politika publike. Për këtë arsye, përdorimi i koncepteve si “gjini”, “barazi gjinore”, “stereotipe gjinore” ose “integrim gjinor” duhet kuptuar në funksion të këtij objekti dhe jo si ndërhyrje në kuptimin juridik të familjes ose martesës.

Për më tepër, barazia gjinore nuk qëndron në kundërshtim me mbrojtjen e familjes. Përkundrazi, ajo është një nga kushtet që familja të funksionojë mbi baza të drejta dhe të qëndrueshme. Një familje mbrohet më mirë kur përgjegjësitë familjare ndahen në mënyrë të barabartë, kur gratë nuk penalizohen ekonomikisht për shkak të amësisë, kur burrat nuk përjashtohen nga roli aktiv prindëror për shkak të stereotipeve, kur dhuna dhe diskriminimi brenda familjes parandalohen dhe kur politikat publike marrin parasysh nevojat reale të prindërve, kujdestarëve dhe fëmijëve.

Nga kjo pikëpamje, ligji nr. 64/2025 e forcon mbrojtjen kushtetuese të familjes. Ai ndihmon në krijimin e kushteve që marrëdhëniet familjare të bazohen në barazi, respekt reciprok dhe ndarje të drejtë të përgjegjësisë. Këto janë elemente që harmonizohen me nenin 53 të Kushtetutës, sepse mbrojtja e veçantë e familjes nuk mund të kuptohet si mbrojtje e pabarazive brenda saj, por si garanci për zhvillimin e saj në kushte dinjiteti dhe drejtësie.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet dallimi ndërmjet mbrojtjes së familjes si institucion kushtetues dhe ruajtjes së roleve tradicionale të pandryshueshme brenda familjes. Neni 53 mbron të drejtën për martesë dhe familje, por nuk kushtëzon këtë mbrojtje me një model të ngurtë të ndarjes së roleve ndërmjet grave dhe burrave. Përkundrazi, një interpretim bashkëkohor i kësaj dispozite kërkon që familja të mbrohet në mënyrë që çdo anëtar i saj të gëzojë të drejta dhe mundësi të barabarta.

Ligji nr. 64/2025 nuk mohon dallimet biologjike dhe as nuk relativizon kategori juridike si gruaja, burri, nëna, babai ose fëmija. Ai përdor termin “gjini” si kategori juridiko-sociale për të analizuar mënyrën se si pritshmëritë shoqërore dhe rolet e ndërtuara mbi bazën e të qenit grua ose burrë mund të krijojnë pengesa në ushtrimin e të drejtave. Ky kuptim nuk zëvendëson biologjinë dhe nuk ndërhyt në marrëdhëniet familjare të rregulluara nga ligje të tjera. Ai vetëm i jep ligjit një instrument për të kuptuar dhe korrigjuar pabarazitë që prekin jetën sociale, ekonomike dhe familjare.

Për shembull, mbrojtja e grave shtatzëna, e nënave të reja ose e prindërve në marrëdhëniet e punës nuk dobësohet nga përdorimi i konceptit “gjini”. Përkundrazi, bëhet më efektive kur shteti kupton se diskriminimi ndaj grave shtatzëna ose penalizimi i amësisë në tregun e punës nuk është vetëm çështje biologjike, por edhe çështje sociale dhe institucionale. Në këtë mënyrë, dimensionin biologjik dhe dimensionin social të barazisë nuk përjashtojnë njëri-tjetrin, por plotësojnë njëri-tjetrin.

Për këtë arsye, nga këndvështrimi i nenit 53 të Kushtetutës, ligji nr. 64/2025 nuk cenon martesën dhe familjen. Ai nuk krijon një regjim të ri familjar, nuk ndryshon kuptimin juridik të martesës dhe nuk ndërhyr në marrëdhëniet juridike familjare. Ai vendos mekanizma të përgjithshëm të barazisë që ndihmojnë edhe vetë familjen të zhvillohet mbi baza më të drejta. Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese duhet të konsiderojë se një ligj që promovon barazi gjinore, ndarje më të drejtë të përgjegjësisë, pjesëmarrje më të barabartë në punë dhe në jetën publike, si dhe parandalim të stereotipeve dhe diskriminimit, nuk është në kundërshtim me familjen. Përkundrazi, ai krijon kushte më të mira për marrëdhënie familjare të bazuara në respekt, dinjitet, përgjegjësi të përbashkët dhe mundësi të barabarta.

Gjithashtu, Neni 54 i Kushtetutës parashikon mbrojtje të posaçme për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Ai gjithashtu vendos detyrimin që fëmijët e lindur jashtë martese të kenë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa dhe mbron fëmijët nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht kur këto cenojnë shëndetin, moralin ose zhvillimin e tyre normal. Kjo dispozitë ka natyrë të qartë mbrojtëse dhe kërkon nga shteti masa aktive për të garantuar zhvillimin e sigurt dhe të barabartë të fëmijëve dhe të rinjve.

Neni 54 nuk duhet interpretuar vetëm si mbrojtje nga dëmtimi fizik ose nga forma të dukshme të abuzimit. Ai përfshin edhe detyrimin për të krijuar një mjedis shoqëror, arsimor dhe institucional që u mundëson fëmijëve të zhvillohen të lirë nga diskriminimi, stereotipet, dhuna dhe trajtimi i pabarabartë. Zhvillimi normal i fëmijës nuk lidhet vetëm me shëndetin fizik, por edhe me formimin e personalitetit, lirinë e zgjedhjes, vetëbesimin, mundësitë arsimore dhe aftësinë për të marrë pjesë në jetën shoqërore pa paragjykime.

Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me nenin 54 të Kushtetutës. Ai synon të kontribuojë në krijimin e një mjedisi ku vajzat dhe djemtë të mos kufizohen nga role të ngurta gjinore, nga pritshmëri të pabarabarta ose nga stereotipe që ndikojnë në zgjedhjet e tyre arsimore, profesionale dhe shoqërore. Luftimi i stereotipeve gjinore nuk cenon fëmijët; përkundrazi, i mbron ata nga kufizime të padrejta që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre të plotë.

Vajzat dhe djemtë dëmtohen kur rriten në modele që u imponojnë role të paracaktuara. Vajzat dëmtohen kur u përcillet mesazhi se disa fusha arsimore, profesione ose pozicione drejtuese nuk janë “për to”. Djemtë dëmtohen kur u imponohet ideja se kujdesi, ndjeshmëria, përgjegjësia familjare ose roli aktiv prindëror janë jashtë identitetit të tyre. Këto stereotipe kufizojnë zhvillimin e lirë të fëmijëve dhe prodhojnë pabarazi që më vonë shfaqen në tregun e punës, në familje, në vendimmarrje dhe në jetën publike.

Prandaj, politikat që synojnë barazinë gjinore në arsim, ndërgjegjësim, media dhe institucione publike janë në përputhje me frymën e nenit 54. Ato synojnë që fëmijët të rriten në një mjedis ku dinjiteti, respekti dhe mundësitë e barabarta janë pjesë e edukimit shoqëror dhe institucional. Kjo nuk përbën ideologjizim të fëmijëve, por zbatim të detyrimit kushtetues për t'i mbrojtur ata nga diskriminimi, dhuna, paragjykimi dhe kufizimet e padrejta.

Një rëndësi të veçantë ka edhe mbrojtja e grave shtatzëna dhe nënave të reja, e parashikuar në nenin 54. Ligji nr. 64/2025 nuk e cenon këtë mbrojtje. Përkundrazi, ai krijon një kornizë më të gjerë për ta bërë atë efektive. Diskriminimi ndaj grave shtatzëna, penalizimi i amësisë në punësim,

veshtirësitë në rikthimin në tregun e punës pas lindjes dhe mungesa e ndarjes së përgjegjëseve familjare janë forma të pabarazisë gjinore që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e garantuar nga neni 54. Një ligj që i adreson këto fenomene nuk bie ndesh me mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave të reja, por e përforcon atë.

Në aspektin normativ, ligji nr. 64/2025 nuk ndryshon statusin juridik të fëmijës, nuk ndërhyr në të drejtat prindërore, nuk modifikon rregullat e kujdestarisë dhe nuk krijon asnjë detyrim që do të cenonte zhvillimin normal të fëmijëve. Ai nuk zëvendëson ligjet e posaçme për mbrojtjen e fëmijëve, arsimin, shëndetin, familjen ose punën, por plotëson kornizën e përgjithshme të barazisë dhe mosdiskriminimit që duhet të orientojë edhe këto fusha.

Neni 54 kërkon që interesi më i lartë i fëmijës të jetë parim udhëheqës në politikat dhe masat që prekin fëmijët. Një mjedis pa diskriminim dhe pa stereotipe kufizuese i shërben këtij interesi. Barazia gjinore në arsim, në komunikim publik dhe në politikat sociale nuk cenon zhvillimin e fëmijës; ajo i krijon atij më shumë mundësi për të zhvilluar potencialin e vet pa u kufizuar nga paragjykimet mbi atë që “duhet” të bëjë një vajzë apo një djalë.

Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 duhet parë si instrument plotësues i mbrojtjes kushtetuese të fëmijëve dhe të rinjve. Ai ndihmon në parandalimin e modeleve diskriminuese që mund të shndërrohen më vonë në dhunë, përjashtim, pabarazi ekonomike ose mungesë përfaqësimi. Kjo është në përputhje me funksionin parandalues të nenit 54, i cili nuk kërkon vetëm reagim pas dëmit, por edhe masa për të shmangur kushtet që e prodhojnë atë.

Për rrjedhojë, nga këndvështrimi i nenit 54 të Kushtetutës, ligji nr. 64/2025 nuk cenon fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna apo nënat e reja. Ai nuk ndryshon statusin e tyre juridik dhe nuk kufizon mbrojtjen që Kushtetuta u jep. Përkundrazi, ai synon të forcojë kushtet institucionale dhe shoqërore për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi, stereotipet dhe pabarazitë. Për këtë arsye, ligji është i pajtueshëm me nenin 54 të Kushtetutës.

Nga analiza e mësipërme rezulton se nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës nuk krijojnë pengesë për miratimin dhe zbatimin e një ligji horizontal për barazinë gjinore. Përkundrazi, mbrojtja e familjes, martesës, fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja kërkon një kuadër ligjor që parandalon diskriminimin, korrigjon pabarazitë dhe promovon ndarje më të drejtë të përgjegjëseve shoqërore e familjare.

Ligji nr. 64/2025 nuk ndërhyr në regjimin juridik të familjes, martesës, prindërisë ose statusit të fëmijës. Ai nuk ndryshon kuptimin juridik të kategorive të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nuk cenon thelbin e të drejtave të garantuara nga nenet 53 dhe 54. Përdorimi i termit “gjini” si kategori juridiko-sociale në fushën e barazisë nuk zëvendëson kategoritë biologjike apo familjare, por shërben për të kuptuar dhe adresuar pabarazitë që ndikojnë në jetën familjare, në mbrojtjen e fëmijëve dhe në dinjitetin e individëve.

Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës. Ai forcon, dhe jo dobëson, mbrojtjen kushtetuese të familjes dhe fëmijëve, duke krijuar kushte më të mira për barazi, dinjitet, respekt reciprok dhe zhvillim të plotë të çdo personi.

- Kontrolli abstrakt i normës dhe hapësira e vlerësimit të ligjvënësit

Në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, Gjykata Kushtetuese ushtron kontroll abstrakt të normës. Ky lloj kontrolli ka për objekt pajtueshmërinë e aktit normativ me Kushtetutën, në përmbajtje dhe në procedurë, dhe jo zëvendësimin e gjykimit politik, social apo teknik të ligjvënësit me një vlerësim tjetër të mundshëm. Për këtë arsye, kontrolli abstrakt nuk synon të përcaktojë nëse ligji është modeli më i mirë, më i plotë ose më i përshtatshëm i politikës publike, por nëse ai qëndron brenda kufijve kushtetues.

Në këtë këndvështrim, në kontrollin abstrakt të normës, Gjykata Kushtetuese nuk zëvendëson vlerësimin politik dhe teknik të ligjvënësit me vlerësimin e saj, përveç rasteve kur provohet qartë se ligji bie ndesh me Kushtetutën, cenon thelbin e një të drejte ose krijon ndërhyrje joproporcionale. Ky standard është i rëndësishëm sepse ligji nr. 64/2025 përfaqëson një zgjedhje legislative në fushën e politikave publike të barazisë.

Ligjvënësi ka hapësirë vlerësimi për të zgjedhur mjetet më të përshtatshme për të realizuar barazinë gjinore, për sa kohë këto mjete janë të arsyeshme, të qarta dhe në përputhje me Kushtetutën. Kundërshtimi ndaj terminologjisë së ligjit nuk mjafton për të provuar antikushtetutshmëri. Për të arritur në një përfundim të tillë, duhet të provohet se ligji krijon një cenim konkret të një dispozite kushtetuese, se prodhon pasoja juridike të papajtueshme me rendin kushtetues, ose se ndërhyrje në mënyrë joproporcionale në të drejtat e garantuara.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e ligjit nr. 64/2025, pasi ai i përket fushës së politikave publike të barazisë, mosdiskriminimit dhe organizimit institucional të mekanizmave shtetërorë për barazi gjinore. Në këto fusha, ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për të identifikuar problemet shoqërore që kërkojnë ndërhyrje, për të zgjedhur mjetet ligjore dhe institucionale që konsideron të përshtatshme, si dhe për të përcaktuar shkallën e ndërhyrjes normative. Roli i Gjykatës Kushtetuese është të verifikojë nëse kjo hapësirë është ushtruar brenda kufijve të Kushtetutës, jo të zëvendësojë politikën ligjvënëse me një model alternativ.

Në një shtet demokratik, Kuvendi ka kompetencën kushtetuese për të miratuar ligje që rregullojnë marrëdhënie të rëndësishme shoqërore dhe që synojnë realizimin e të drejtave themelore. Barazia gjinore është pikërisht një fushë ku Kushtetuta jo vetëm lejon, por edhe kërkon ndërhyrje aktive të ligjvënësit. Nenet 3, 15 dhe 18 të Kushtetutës, të lexuara së bashku, e vendosin shtetin përballë detyrimit për të garantuar dinjitetin njerëzor, për të kontribuar në realizimin e të drejtave dhe për të parandaluar diskriminimin. Për rrjedhojë, miratimi i një ligji horizontal për barazinë gjinore është në vetvete një ushtrim i kompetencës kushtetuese të Kuvendit dhe jo një devijim prej saj.

Në kontrollin abstrakt të normës, një ligj mund të shpallet antikushtetues vetëm kur rezulton se bie në kundërshtim me një dispozitë konkrete të Kushtetutës, cenon thelbin e një të drejte ose lirie themelore, krijon ndërhyrje joproporcionale, cenon parimin e sigurisë juridike, tejkalon kompetencën e organit që e ka miratuar, ose bie ndesh me detyrimet kushtetuese që burojnë nga rendi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Mospajtimi politik, moral, kulturor ose ideologjik me një zgjedhje të ligjvënësit nuk është i mjaftueshëm për të aktivizuar konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën.

Për këtë arsye, kundërshtimi ndaj terminologjisë së ligjit nuk mund të jetë, në vetvete, bazë për shfuqizimin e tij. Nëse termat e përdorur nga ligjvënësi janë të lidhur me objektin e ligjit, janë të

kuptueshëm në kontekstin e tij, mbështeten në standarde të njohura të së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane dhe nuk krijojnë pasoja juridike që cenojnë një të drejtë kushtetuese, atëherë përdorimi i tyre hyn në hapësirën e vlerësimit të ligjvënësit. Kontrolli kushtetues nuk mund të shndërrohet në kontroll të preferencës terminologjike të ligjvënësit, përveçse kur terminologjia krijon paqartësi të tillë normative që cenon sigurinë juridike ose prodhon efekte antikushtetuese.

Në rastin konkret, ligji nr. 64/2025 përdor koncepte si “gjini”, “barazi gjinore”, “integrim gjinor”, “stereotipe gjinore”, “gjuhë me ndjeshmëri gjinore” dhe “përkatësi e shumëfishtë” në funksion të objektit të tij: garantimit të barazisë gjinore dhe parandalimit të diskriminimit. Këto koncepte nuk janë të panjohura për rendin juridik shqiptar dhe as të shkëputura nga standardet ndërkombëtare. Ato përdoren për të identifikuar dhe trajtuar pabarazitë që lindin nga rolet, pritshmëritë dhe barrierat shoqërore që prekin gratë dhe burrat. Për rrjedhojë, ato kanë funksion normativ dhe analitik të lidhur drejtpërdrejt me qëllimin e ligjit.

Në vlerësimin e proporcionalitetit, duhet të analizohet nëse ligji ndjek një qëllim legjitim, nëse mjetet që përdor janë të përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi, nëse ato janë të nevojshme dhe nëse ruhet një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të individëve. Ligji nr. 64/2025 ndjek një qëllim qartësisht legjitim: realizimin efektiv të barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit, forcimin e mekanizmave institucionalë dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në këtë fushë. Ky qëllim lidhet drejtpërdrejt me nenet 3, 15, 18, 53, 54, 5 dhe 122 të Kushtetutës.

Mjetet e zgjedhura nga ligji janë gjithashtu të përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi. Ligji parashikon mekanizma institucionalë, detyrime për integrimin e perspektivës gjinore, masa për parandalimin e stereotipeve, standarde për komunikim institucional, mbledhje dhe përdorim të të dhënave, si dhe instrumente për monitorim dhe zbatim. Këto janë mjete tipike të një ligji horizontal për barazinë dhe janë të përshtatshme për të adresuar pabarazi që nuk zgjidhen vetëm me ndalime të përgjithshme të diskriminimit.

Po ashtu, masat e ligjit janë të nevojshme në kuptimin kushtetues, pasi barazia gjinore nuk mund të arrihet vetëm përmes deklarimeve formale. Pabarazitë gjinore shpesh shfaqen në praktika institucionale, stereotipe, mungesë të dhënash, përfaqësim të ulët, ndarje të pabarabartë të përgjegjësi dhe mungesë mekanizmash të posaçëm monitorimi. Nëse shteti nuk ndërton instrumente konkrete për t’i identifikuar dhe korrigjuar këto dukuri, barazia mbetet e dekluar, por jo e realizuar. Ligji nr. 64/2025 i përgjigjet kësaj nevojë përmes mjeteve të arsyeshme dhe të natyrës kryesisht institucionale e programore.

Nga ana tjetër, ligji nuk cenon thelbin e ndonjë të drejte kushtetuese. Ai nuk ndalon lirinë e shprehjes, nuk imponon bindje ideologjike, nuk ndërhyr në lirinë e ndërgjegjes, nuk ndryshon regjimin juridik të familjes dhe martesës, nuk cenon të drejtat prindërore dhe nuk krijon detyrime arbitrare ndaj individëve. Përmbajtja e tij është e orientuar drejt institucioneve, politikave publike dhe mekanizmave të barazisë. Për rrjedhojë, ekuilibri ndërmjet qëllimit publik dhe të drejtave individuale është i ruajtur.

Në këtë analizë duhet theksuar edhe parimi i vetëpërmbajtjes gjyqësore në raport me zgjedhjet ligjvënëse. Kur ligjvënësi vepron në një fushë ku Kushtetuta i njeht hapësirë vlerësimi dhe ku masa

e miratuar ndjek një qëllim legjitim, Gjykata Kushtetuese ndërhyt vetëm nëse mjete i zgjedhur është haptazi i paarsyeshëm, arbitrar ose joproporcional. Në mungesë të një cenimi të tillë, ekzistenca e alternativave të tjera të mundshme ligjore nuk e bën ligjin antikushtetues. Fakti që disa subjekte mund të preferonin një formulim tjetër, një terminologji tjetër ose një model tjetër politikash nuk mjafton për të rrëzuar zgjedhjen e Kuvendit.

Gjithashtu, në kontrollin abstrakt të normës, pretendimi për antikushtetutshmëri duhet të lidhet me pasoja juridike konkrete ose të paktën të parashikueshme të normës. Një tension i përgjithshëm ideologjik me konceptet e ligjit nuk është i barasvlershëm me cenim të Kushtetutës. Për të justifikuar shfuqizimin e një norme, duhet të identifikohet qartë se cilën dispozitë kushtetuese cenon ligji, në çfarë mënyre e cenon dhe pse ky cenim nuk mund të shmanget përmes interpretimit pajtues me Kushtetutën. Në rastin e ligjit nr. 64/2025, dispozitat e tij mund dhe duhet të lexohen në mënyrë sistematike, në harmoni me Kushtetutën, me ligjet sektoriale dhe me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara.

Në këtë kuptim, parimi i interpretimit pajtues me Kushtetutën ka rëndësi të veçantë. Kur një normë mund të interpretohet në mënyrë që respekton Kushtetutën dhe të drejtat themelore, Gjykata duhet të preferojë atë interpretim përpara shfuqizimit. Ligji nr. 64/2025 mund të interpretohet qartësisht si ligj që rregullon barazinë gjinore, politikën publike dhe mekanizmat institucionalë, pa ndërhyrë në statusin civil, në regjimin e familjes, në martesë, në prindëri ose në fusha të tjera të rregulluara nga ligje të posaçme. Ky interpretim është jo vetëm i mundshëm, por edhe më i natyrshmi në dritën e objektit të ligjit.

Për më tepër, ligji nr. 64/2025 duhet të vlerësohet edhe në raport me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Në një fushë ku shteti ka marrë përsipër detyrime për të luftuar diskriminimin, stereotipet gjinore, dhunën ndaj grave dhe pabarazitë strukturore, hapësira e vlerësimit të ligjvënësimit për të miratuar masa pozitive është e gjerë. Shfuqizimi i një ligji që synon përmbushjen e këtyre detyrimeve do të kërkonte një arsyetim të fortë kushtetues, të bazuar në cenim real të të drejtave ose në papajtueshmëri të qartë me Kushtetutën. Një bazë e tillë nuk rezulton.

Në rastin konkret, ligji nr. 64/2025 ka një qëllim legjitim, përdor mjete të arsyeshme, është i lidhur me detyrimet pozitive të shtetit dhe nuk cenon thelbin e asnjë të drejte kushtetuese. Ai përfaqëson një zgjedhje ligjvënëse të lejuar në fushën e politikave publike të barazisë. Për këtë arsye, ai duhet vlerësuar si ushtrim i ligjshëm i kompetencës së Kuvendit dhe jo si cenim i rendit kushtetues.

Sa më sipër, në këtë kontroll, Gjykata Kushtetuese duhet të mbajë një dallim të qartë ndërmjet kontrollit juridik të kushtetutshmërisë dhe vlerësimit politik të përshtatshmërisë së ligjit. Ligji nr. 64/2025 mund të jetë objekt debati publik, politik ose akademik, si çdo akt i rëndësishëm normativ, por ky debat nuk e bën atë antikushtetues. Për sa kohë që ligji qëndron brenda kufijve të Kushtetutës, ndjek një qëllim legjitim dhe përdor mjete proporcionale, zgjedhja e bërë nga ligjvënësi duhet respektuar.

IV

Vlefshmëria procedurale dhe konsultimi publik

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, një element me rëndësi është edhe mënyra se si është zhvilluar procesi paraprak i hartimit, konsultimit dhe vlerësimit të projektligjit. Nga dokumentacioni shoqërues i projektligjit përpara miratimit, përfshirë relacionin shoqërues dhe raportin e vlerësimit të ndikimit rregullator, rezulton se projektligji nuk është hartuar në mënyrë të mbyllur, të njëanshme apo të papritur, por ka kaluar nëpër një proces të strukturuar konsultimi institucional, publik dhe ndërsektorial. Ky proces është zhvilluar në përputhje me logjikën e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, me rregullat e hartimit të akteve normative dhe me standardin e ligjbërjes së kujdesshme në një shtet demokratik të së drejtës.

Nga pikëpamja kushtetuese, konsultimi publik nuk duhet kuptuar si një procedurë formale që mjaftohet me publikimin e një drafti, por si një proces që u jep aktorëve të interesuar mundësinë reale për t’u informuar, për të paraqitur komente dhe për të ndikuar në përmirësimin e tekstit normativ. Në rastin konkret, dokumentacioni shoqërues i projektligjit tregon se ky standard është përmbushur në disa nivele: përmes punës ndërinstitucionale, konsultimit me organizatat e shoqërisë civile, konsultimit me sektorin privat, dialogut me partnerët ndërkombëtarë, konsultimit me aktorët e medias, publikimit në platformën zyrtare të konsultimit publik dhe marrjes së mendimeve nga institucionet shtetërore të interesuara.

Procesi i hartimit nisi me ngritjen e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, me Urdhrin nr. 39, datë 24.01.2024, të ministrit përgjegjës. Përbërja e këtij grupi kishte karakter të gjerë dhe ndërsektorial, me pjesëmarrjen e institucioneve kyçe si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, INSTAT, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Ministria përgjegjëse për pushtetin vendor dhe institucione të tjera relevante. Kjo dëshmon se drafti nuk është konceptuar si produkt i një institucioni të vetëm, por si rezultat i një procesi koordinimi horizontal brenda administratës shtetërore (Shih relacionin shoqërues të Projektligjit “Për barazinë gjinore”, RENJK)

Ky aspekt ka rëndësi të veçantë për Gjykatën Kushtetuese, sepse një ligj horizontal për barazinë gjinore prek fusha të ndryshme të politikave publike: arsimin, punësimin, mbrojtjen sociale, administratën publike, median, statistikën, vendimmarrjen, shërbimet publike dhe mekanizmat kundër diskriminimit. Për këtë arsye, përfshirja e institucioneve të ndryshme në fazën e hartimit nuk është thjesht element procedural, por kusht për cilësinë dhe racionalitetin e vetë ligjit. Një ligj i tillë kërkon vlerësim të ndërthurur juridik, social, financiar, institucional dhe administrativ.

Relacioni shoqërues dhe dokumentacioni administrativ tregojnë se Grupi i Punës ka zhvilluar disa mbledhje gjatë viteve 2024 dhe 2025, në të cilat janë identifikuar mangësitë e kuadrit ekzistues ligjor, janë diskutuar nevojat për përditësimin e ligjit të mëparshëm dhe janë reflektuar komente konkrete në variantet e mëvonshme të draftit. Kjo tregon se procesi nuk ka qenë formal apo dekorativ. Përkundrazi, konsultimi ndërinstitucional ka pasur ndikim real në përmbajtjen e projektligjit, duke kontribuar në rishikimin, saktësimin dhe përmirësimin e zgjidhjeve normative.

Një element tjetër i rëndësishëm është konsultimi i drejtpërdrejtë me organizatat e shoqërisë civile. Sipas të dhënave të procesit, projektligji është diskutuar në mbledhjen e datës 22 korrik 2024 me

një numër të konsiderueshëm organizatash dhe rrjetesh të angazhuara në fushën e barazisë gjinore, të drejtave të grave, mbrojtjes nga dhuna, të drejtave të fëmijëve, përfshirjes sociale dhe zhvillimit komunitar. Ndër organizatat pjesëmarrëse përmenden GADC, Co-Plan, World Vision, Different & Equal, Nisma Arsis, CRCA, Qendra për Drejtësi Gjinore, Vatra, Aleanca Kombëtare e Këshillave Vendorë dhe aktorë të tjerë. Ftesa për të paraqitur komente me shkrim dhe reflektimi i një pjese të tyre në draft tregojnë se pjesëmarrja e shoqërisë civile ka qenë reale dhe jo vetëm nominale.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një fushë si barazia gjinore, ku organizatat e shoqërisë civile kanë përvojë të drejtpërdrejtë me grupet që preken nga diskriminimi, dhuna me bazë gjinore, përjashtimi social, varësia ekonomike dhe pengesat në aksesin në shërbime. Përfshirja e tyre në konsultim i jep procesit një dimension praktik dhe të bazuar në realitetin shoqëror që ligji synon të adresojë. Në këtë kuptim, konsultimi me shoqërinë civile ka kontribuar jo vetëm në legjitimitetin procedural të projektligjit, por edhe në përshtatshmërinë materiale të zgjidhjeve të tij.

Dokumentacioni shoqëruar tregon gjithashtu se janë zhvilluar konsultime të posaçme me sektorin privat dhe komunitetin e biznesit, përfshirë takimin e datës 11 shtator 2024. Ky konsultim ka rëndësi të posaçme, sepse ligji nr. 64/2025 nuk kufizohet vetëm në institucionet publike, por prek edhe fusha si punësimi, përfaqësimi, mundësitë e barabarta, balanca punë-jetë, puna e papaguar dhe masat kundër diskriminimit në mjedisin e punës. Përfshirja e sektorit privat tregon se hartuesit kanë vlerësuar ndikimin praktik të ligjit mbi subjektet që do të jenë pjesë e zbatimit të tij.

Ky element lidhet drejtpërdrejt edhe me raportin e vlerësimit të ndikimit rregullator. RIA nuk është thjesht dokument teknik, por instrument që ndihmon në vlerësimin e nevojës për ndërhyrje ligjore, alternativave të mundshme, ndikimeve institucionale, administrative, sociale dhe ekonomike, si dhe kostove e përfitimeve të pritshme. Në rastin konkret, fakti që projektligji është shoqëruar me vlerësim rregullator tregon se ndërhyrja ligjore është analizuar në raport me problemet që synon të zgjidhë, me aktorët që preken dhe me efektet e mundshme të zbatimit. Kjo e forcon arsyeshmërinë e zgjedhjes ligjvënëse.

Po kështu, konsultimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë UN Women, UNDP, UNICEF, IOM, Delegacionin e Bashkimit Evropian, GIZ, OSBE, ADA, AICS dhe ambasada të vendeve partnere, tregon se projektligji është shqyrtuar edhe në dritën e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Në fushën e barazisë gjinore, ky element ka rëndësi të veçantë, pasi Shqipëria ka detyrime që burojnë nga Konventa CEDAW, Konventa e Stambollit, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, përfshirja e ekspertizës ndërkombëtare nuk dobëson karakterin sovran të procesit ligjvënës, por ndihmon në harmonizimin e ligjit me detyrimet që vetë shteti shqiptar ka pranuar.

Një tjetër komponent i konsultimit ka qenë dialogu me aktorët e medias, përmes Forumit të Medias të mbështetur nga UN Women, në datën 3 tetor 2024. Ky konsultim ka trajtuar çështje si gjuha me ndjeshmëri gjinore, trajtimi i stereotipeve gjinore dhe roli i medias në promovimin e barazisë. Duke qenë se ligji përfshin edhe standarde që lidhen me komunikimin publik dhe paraqitjen jo-stereotipike të grave dhe burrave, konsultimi me median ka qenë i nevojshëm dhe i përshtatshëm.

Kjo tregon se hartuesit kanë marrë në konsideratë edhe shqetësimet e sektorëve që mund të ndikohen nga këto dispozita.

Drafti është publikuar zyrtarisht në Platformën Kombëtare të Konsultimit Publik më datë 10 mars 2025. Ky publikim përmbush kërkesën bazë të ligjit nr. 146/2014 për transparencë dhe akses të publikut në tekstin e projektaktit. Sipas të dhënave të procesit, drafti ka qenë i aksesueshëm për publikun e gjerë dhe ka pasur rreth 951 shikime. Publikimi në platformën zyrtare është element i rëndësishëm, sepse garanton mundësinë e çdo personi ose subjekti të interesuar për t'u njohur me projektligjin dhe për të paraqitur komente.

Megjithatë, procesi nuk u kufizua vetëm në publikimin online. Duke qenë se përmes platformës u paraqitën vetëm dy komente me shkrim, ministria përgjegjëse zhvilloi një takim fizik shtesë konsultues më 10 prill 2025 me organizata të shoqërisë civile dhe aktorë lokalë, ku u paraqitën komente të tjera. Ky fakt ka rëndësi të posaçme për vlerësimin kushtetues të procesit. Ai tregon se autoriteti propozues nuk u mjaftua me përmbushjen minimale formale të procedurës, por ndërmori hapa shtesë për të nxitur pjesëmarrjen dhe për të mbledhur mendime më të gjera.

Dokumentacioni administrativ evidenton se rreth 90% e komenteve të paraqitura janë reflektuar pjesërisht ose tërësisht në tekstin final të ligjit. Ky është një tregues i rëndësishëm i natyrës substanciale të konsultimit. Ligji nr. 146/2014 nuk kërkon që çdo koment të pranohet, sepse vendimmarrja normative i takon autoritetit propozues dhe më pas Kuvendit. Megjithatë, kur një pjesë e konsiderueshme e komenteve reflektohen në draft, kjo tregon se konsultimi ka pasur ndikim real dhe nuk ka qenë procedurë e zbrazët.

Përveç konsultimit publik, projektligji iu dërgua për mendim një rrethi të gjerë institucionesh shtetërore, përfshirë ministrinë e linjës, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, AKSHI-n, DAP-in, INSTAT-in dhe institucione të tjera relevante. Ky konsultim ndërinstitutional është i rëndësishëm sepse ligji për barazinë gjinore ka karakter horizontal dhe zbatimi i tij kërkon koordinim ndërmjet shumë institucioneve. Reflektimi i komenteve të këtyre institucioneve në variantin përfundimtar tregon se drafti është përpunuar në mënyrë të dokumentuar dhe të arsyetuar.

Nga pikëpamja juridike, standardi kushtetues nuk kërkon unanimitet në konsultim dhe as pranimin e çdo qëndrimi të paraqitur nga palët e interesuara. Konsultimi publik garanton të drejtën për informim, pjesëmarrje dhe paraqitje mendimesh; ai nuk krijon të drejtën e vetos mbi përmbajtjen e ligjit. Në një demokraci përfaqësuese, vendimmarrja përfundimtare normative i takon Kuvendit, si organ përfaqësues i sovranitetit popullor. Për rrjedhojë, fakti që disa komente ose qëndrime nuk janë pranuar nuk e bën procesin antikushtetues, për sa kohë është garantuar mundësia reale për pjesëmarrje dhe autoritetet kanë zhvilluar një proces të arsyeshëm shqyrtimi.

Kjo qasje është e rëndësishme për të dalluar midis mungesës së konsultimit dhe mospajtimit me rezultatin e konsultimit. Mungesa e konsultimit do të ekzistonte nëse drafti nuk do të ishte publikuar, nëse aktorët e interesuar nuk do të kishin pasur mundësi të informoheshin, nëse nuk do të ishin ftuar institucionet relevante, ose nëse komentet do të ishin injoruar tërësisht. Në rastin konkret, dokumentacioni shoqëruar tregon të kundërtën: drafti është konsultuar në disa faza, me kategori të ndryshme aktorësh dhe me reflektim të dokumentuar të komenteve.

Po ashtu, raporti i vlerësimit të ndikimit rregullator mbështet arsyetimin se ndërhyrja ligjore ka qenë e nevojshme dhe e analizuar. Një RIA e hartuar në kuadër të procesit ligjvënës tregon se projektligji është shqyrtuar në raport me problemin që synon të zgjidhë, objektivat e politikës, ndikimet e pritshme, zbatueshmërinë institucionale dhe alternativat e mundshme. Për një ligj horizontal si ky, vlerësimi rregullator ka rëndësi të shtuar, sepse ndihmon në identifikimin e efekteve ndërsektoriale dhe në justifikimin e masave të propozuara.

Në këtë mënyrë, relacioni shoqërues dhe RIA funksionojnë si dokumente që shpjegojnë racionalitetin e ndërhyrjes ligjore. Ato tregojnë se ligji nr. 64/2025 nuk është produkt i një vendimmarrjeje të papritur, por i një procesi ku janë analizuar nevojat për përmirësimin e kuadrit ekzistues, mangësitë e ligjit të mëparshëm, detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe ndikimi i pritshëm mbi institucionet dhe grupet e interesit. Kjo ka rëndësi për Gjykatën Kushtetuese, sepse një ligj i shoqëruar me analizë, konsultim dhe arsyetim të dokumentuar gëzon një prezumim më të fortë të ligjbërjes së arsyeshme.

Në përfundim, nga dokumentacioni shoqërues i projektligjit, relacioni dhe raporti i vlerësimit rregullator rezulton se procesi i hartimit të ligjit nr. 64/2025 ka qenë i gjerë, i strukturuar dhe shumëfazësh. Ai ka përfshirë konsultim ndërinstitutional, konsultim publik, pjesëmarrje të shoqërisë civile, sektorit privat, medias, aktorëve lokalë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Komentet e paraqitura janë shqyrtuar dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre është reflektuar në tekstin final.

Për rrjedhojë, nuk mund të konkludohet se ligji nr. 64/2025 është miratuar në mungesë të transparencës, pjesëmarrjes ose arsyetimit institucional. Përkundrazi, provat dokumentare dëshmojnë një proces konsultimi substancial dhe efektiv, në përputhje me legjislacionin për konsultimin publik, me kërkesat e ligjbërjes së mirë dhe me standardet e shtetit të së drejtës. Kjo mbështet përfundimin se procedura paraprake e hartimit dhe konsultimit të projektligjit nuk paraqet cenim kushtetues dhe nuk mund të shërbejë si bazë për vënien në dyshim të vlefshmërisë së ligjit.

V

Termi “gjini” dhe përputhshmëria e tij me rendin juridik shqiptar

Një nga çështjet thelbësore që kërkon sqarim në këtë gjykim është kuptimi juridik i termit “gjini” në ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” dhe raporti i këtij termi me rendin kushtetues dhe ligjor shqiptar. Për qëllime të këtij Opinioni **Amicus Curiae**, analiza duhet të nisë nga një premisë e qartë: përdorimi i termit “gjini” në ligjin nr. 64/2025 nuk përbën krijim të një kategorie të re civile, nuk zëvendëson seksin biologjik dhe nuk ndryshon regjimet juridike të familjes, gjendjes civile, martesës, prindërisë apo përgjegjësisë penale. Ai përdoret si nocion juridiko-social në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, për të identifikuar rolet, pritshmëritë, stereotipet dhe barrierat shoqërore që mund të prodhojnë pabarazi ndërmjet grave dhe burrave.

Ky dallim është i rëndësishëm për Gjykatën Kushtetuese, sepse kontrolli kushtetues i normës nuk mund të mbështetet në një lexim të izoluar ose të shkëputur të një termi nga objekti i ligjit. Ligji nr. 64/2025 është ligj horizontal për barazinë gjinore. Qëllimi i tij është të ndërtojë mekanizma për realizimin efektiv të barazisë, parandalimin e diskriminimit, integrimin e perspektivës gjinore në

politikat publike dhe forcimin e institucioneve përgjegjëse. Prandaj, termi “gjini” duhet lexuar në funksion të këtij qëllimi dhe jo si term që synon të rregullojë statusin civil ose biologjik të personit.

Pretendimi se përmes ligjit nr.64/2025, Kuvendi vendosi të ndryshojë kuptimin e vetë fjalës “gjini”, duke e definuar “*gjininë sipas Nenit 4 (ë), si rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat nuk qëndron as në planin juridik, as në planin historik të zhvillimit të legjislacionit shqiptar, as në raport me standardet ndërkombëtare dhe evropiane që Shqipëria ka pranuar dhe është zotuar të zbatojë.*

Së pari, termi “gjini” nuk është risi e ligjit nr. 64/2025 dhe as një koncept i futur për herë të parë në rendin juridik shqiptar. Përkundrazi, ai është pjesë e legjislacionit vendas prej më shumë se një deкаде. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, përdorte shprehimisht këtë terminologji dhe jepte një përkufizim të qartë për nocionin e përkatësisë gjinore. Neni 4, shkronja c e ligjit si më lart parashikonte se: “*Përkatësi gjinore janë mundësitë dhe atributet shoqërore, të lidhura me të qenit femër apo mashkull, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.*” Ky formulim ka rëndësi të posaçme kushtetuese, sepse dëshmon se ligjvënësi shqiptar që në vitin 2008 ka bërë dallimin ndërmjet dimensionit biologjik të seksit dhe dimensionit shoqëror të roleve, pritshmërive dhe marrëdhënieve ndërmjet grave dhe burrave. Për rrjedhojë, **ligji i ri nuk krijon një koncept të panjohur, por vijon dhe përditëson një traditë ekzistuese normative.**

Ky konstatim përforcohet nga fakti se termi “gjini” dhe nocionet e lidhura me të janë përdorur ndër vite edhe në akte të tjera të rendit juridik shqiptar. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kodi i Punës, Kodi i Procedurave Administrative, si dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, i referohen gjinisë si kategori juridike të mbrojtur dhe si element i politikave publike. Në këtë kuptim, pretendimi se përdorimi i termit “gjini” cenon sigurinë juridike është i pabazuar, pasi kemi të bëjmë me një nocion tashmë të konsoliduar në praktikën legjislative shqiptare.

Për Gjykatën Kushtetuese, ky element është i rëndësishëm në raport me parimin e sigurisë juridike. Një nocion që është përdorur prej vitesh në legjislacion dhe në dokumente publike, dhe që lidhet me një fushë të caktuar rregullimi, nuk mund të konsiderohet i paqartë ose i papajtueshëm me Kushtetutën vetëm për shkak se është objekt debati publik. Siguria juridike kërkon qartësi të arsyeshme dhe kuptueshmëri funksionale, jo ngurtësim të terminologjisë ligjore në një kuptim të vetëm për të gjitha fushat e së drejtës.

Së dyti, në planin ndërkombëtar, termi “gjini” përbën standard të vendosur prej dekadash në të drejtën e të drejtave të njeriut. Sistemi i Kombeve të Bashkuara dhe UN Women e përkufizon gjininë si rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat. Në dokumentet e OKB-së, gjinia përdoret pikërisht për të kuptuar se si ndarja tradicionale e roleve shoqërore mund të prodhojë pabarazi në arsim, punësim, përfaqësim politik apo akses në shërbime publike. Ky është po ai kuptim që gjejmë në ligjin shqiptar të vitit 2008 dhe në ligjin aktual.

Edhe më domethënës është fakti se Shqipëria është palë në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, e cila në nenin 3 jep

përkufizimin e termit “gjini”, duke sanksionuar se ai nënkupton “rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e ndërtuara shoqërisht që një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat”. Pra, një traktat ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë nga viti 2013 (04.02.2013) përdor në mënyrë të drejtpërdrejtë të njëjtin nocion që kundërshtohet nga kërkuuesit. Kjo Konventë, ka hyrë në fuqi në 1.08.2014. Sipas nenit 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëhen pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të zakonshme. Kjo do të thotë se përdorimi i termit “gjini” **jo vetëm që nuk bie ndesh me Kushtetutën, por gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në mekanizmin kushtetues të integritetit të së drejtës ndërkombëtare**.

Po kështu, Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW), edhe pse historikisht përdor termin diskriminim ndaj grave, e ndërton gjithë logjikën e saj mbi nevojën për të ndryshuar rolet tradicionale dhe stereotipet që cenojnë barazinë reale. Neni 5 i saj detyron shtetet të ndërmarrin masa për të modifikuar modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave. Një detyrim i tillë do të ishte i pakuptimtë pa konceptin e gjinisë si kategori shoqërore. Me fjalë të tjera, vetë CEDAW presupozon ekzistencën juridike të nocionit që kërkuuesit synojnë të mohojnë.

Në planin evropian, pretendimi bëhet edhe më i paqëndrueshëm. Bashkimi Evropian e përdor gjerësisht nocionin “barazi gjinore” në politikën dhe legjislacionin e tij. Direktiva 2006/54/EC mbi barazinë në punësim, Direktiva 2019/1158 për balancën punë-jetë, Direktiva 2022/2381 për ekuilibrin gjinor në bordet drejtuese dhe Direktiva 2023/970 për transparencën e pagave synojnë të adresojnë pabarazi që janë tipikisht gjinore: ndarja e roleve familjare, hendeku i pagave, mungesa e grave në drejtim apo pengesat strukturore në tregun e punës. Edhe kur terminologjia tradicionale e disa akteve përdor fjalën “seks”, përmbajtja materiale e tyre adreson pabarazi që *burojnë nga rolet dhe pritshmëritë gjinore*.

Konkretisht:

Direktiva 2006/54/EC mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim trajton diskriminimin në punë, hendekun e pagave dhe pengesat strukturore që prekin gratë në tregun e punës. Kjo direktivë është instrument klasik i barazisë gjinore dhe në praktikën evropiane, ajo lidhet drejtpërdrejt me politikën e integritetit gjinor.

Direktiva 2019/1158 mbi balancën ndërmjet jetës profesionale dhe asaj familjare për prindërit dhe kujdestarët është shembull tipik i një instrumenti që adreson role tradicionale gjinore. Ajo synon të rrisë pjesëmarrjen e burrave në kujdesin familjar dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, duke korrigjuar ndarjen tradicionale të përgjegjësi.

Direktiva 2022/2381 mbi përmirësimin e ekuilibrit gjinor në bordet e shoqërive të listuara përdor shprehimisht termin “balancë gjinore” dhe synon të korrigjojë nën-përfaqësimin historik të grave në pozicionet drejtuese.

Direktiva 2023/970 mbi transparencën e pagave synon luftimin e “hendekut gjinor në paga”, duke vendosur mekanizma transparence dhe barrë prove për diskriminimin në pagë.

Për këtë arsye, heqja e termit “gjini” nga legjislacioni shqiptar do të krijonte mospërputhje me acquis të Bashkimit Evropian, jo harmoni me të.

Ky standard reflektohet qartë edhe në praktikat e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), organi specializuar i Bashkimit Evropian, i cili e përkufizon gjininë si *atributet sociale dhe mundësitë që lidhen me të qenit femër apo mashkull dhe me marrëdhëniet ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve*. Ky përkufizim është pothuaj identik me atë të përdorur nga ligji shqiptar nr. 9970/2008, çka tregon se Shqipëria ka qenë prej kohësh në linjë me standardin evropian.

Në planin kushtetues të brendshëm, kundërshtimi ndaj termit “gjini” nuk qëndron edhe për një arsye tjetër themelore: nuk identifikohet asnjë normë e Kushtetutës që ndalon përdorimin e tij. Kushtetuta nuk përmban një fjalor të mbyllur juridik dhe nuk pengon evoluimin terminologjik të legjislacionit. Përkundrazi, jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka pranuar se ligjvënësi gëzon hapësirë vlerësimi në përcaktimin e mjeteve dhe nocioneve për realizimin e interesit publik, për sa kohë respektohen të drejtat themelore dhe parimi i proporcionalitetit. Në rastin konkret, termi “gjini” nuk kufizon të drejta, nuk krijon detyrime arbitrare dhe nuk cenon askënd; ai thjesht shërben si instrument analitik dhe normativ për të identifikuar pabarazitë reale.

Në këtë kuptim, debati kushtetues që duhet shtruar nuk është nëse një term është objekt debati ideologjik, por nëse përdorimi i tij në ligj cenon një të drejtë kushtetuese, krijon paqartësi të papajtueshme me sigurinë juridike, ndërhyt në thelbin e lirive themelore, ose bie ndesh me ndonjë dispozitë të caktuar të Kushtetutës. Në rastin e ligjit nr. 64/2025, një cenim i tillë nuk rezulton.

Siç e referuam më sipër, termi “gjini” nuk krijon detyrime arbitrare ndaj individëve, nuk kufizon lirinë e shprehjes, nuk ndryshon statusin civil, nuk ndërhyt në regjistrat publikë, nuk prek martesën, prindërinë ose familjen dhe nuk krijon kategori të reja juridike civile. Ai përdoret brenda një ligji të veçantë, me objekt të qartë, për të orientuar politikat publike dhe masat kundër diskriminimit. Për këtë arsye, përdorimi i tij qëndron brenda hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit.

Gjykata Kushtetuese, në kontrollin abstrakt të normës, nuk zëvendëson vlerësimin e ligjvënësit mbi terminologjinë më të përshtatshme, përveçse kur kjo terminologji prodhon efekte antikushtetuese. Në rastin konkret, termi “gjini” ka kuptim të përcaktuar, lidhet me objektin e ligjit dhe është i njohur në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar. Për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet burim i pasigurisë juridike.

Për më tepër, edhe në kuptimin funksional, në ligjin nr. 64/2025, termi “gjini” përdoret për të përshkruar rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e ndërtuara shoqërisht, të cilat një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat. Ky është një kuptim funksional, i lidhur me objektin e ligjit: identifikimin dhe korrigjimin e pabarazive që nuk burojnë thjesht nga teksti i ligjeve, por nga praktikat, stereotipet dhe strukturat shoqërore.

Në këtë kuptim, termi “gjini” nuk përdoret për të zëvendësuar seksin biologjik. Ai nuk mohon ekzistencën e grave dhe burrave si kategori biologjike dhe juridike, nuk ndryshon kuptimin e nënës, babait, fëmijës, gruas shtatzënë apo bashkëshortëve në legjislacionin sektorial. Ai shërben për të analizuar se si mbi bazën e të qenit grua ose burrë krijohen role të pritshme shoqërore, të cilat mund të prodhojnë pasoja të pabarabarta në arsim, punësim, familje, media, politikë, ekonomi dhe vendimmarrje.

Për shembull, hendeku gjinor në paga nuk shpjegohet vetëm nga dallimet biologjike. Ai lidhet me ndarjen e pabarabartë të përgjegjësiwe familjare, me ndërprerjet në karrierë për shkak të kujdesit, me stereotipet profesionale dhe me nënvlerësimin e punëve që kryhen kryesisht nga gratë. Po kështu, nën-përfaqësimi i grave në vendimmarrje nuk është çështje biologjike, por rezultat i barrierave historike, kulturore dhe institucionale. Dhuna me bazë gjinore, gjithashtu, nuk mund të kuptohet pa analizuar marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe stereotipet mbi rolet e grave dhe burrave në familje dhe shoqëri.

Pikërisht për këtë arsye, ligji ka nevojë për termin “gjini”. Pa këtë koncept, shteti do të kishte vështirësi të identifikonte pabarazitë që nuk janë të dukshme vetëm në nivel formal, por që prodhohen nga mënyra se si shoqëria organizon rolet, pritshmëritë dhe mundësitë për gratë dhe burrat. Në këtë kuptim, termi “gjini” është instrument juridik për zbatimin e nenit 18 të Kushtetutës, jo cenim i tij.

Sa më sipër, përkufizimi që ligji nr.64/2025 i bën termit “gjini”:

- a) Nuk është devijim nga rendi kushtetues shqiptar
- b) Është në harmoni me përkufizimin e përdorur nga instrumentet dhe traktatet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është pjesë dhe janë pjesë e sistemit juridik të brendshëm
- c) Është në harmoni me përkufizimin dhe kuptimin që përdoret nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe në linjë me legjislacionin primar të BE (direktivat evropiane)
- d) Nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm sektorial, Kodi i familjes, Kodi Civil, Ligji “Për gjendjen civile” dhe
- e) Në çdo rast e lidh konceptin “gjini” me rolet, atributet sociale që lidhen me të qenit **burrë ose grua**.

VI.

Raporti me legjislacionin sektorial: mungesa e konfliktit normativ

Një çështje e rëndësishme për vlerësimin kushtetues të ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” është raporti i tij me legjislacionin sektorial ekzistues, veçanërisht me Kodin e Familjes, ligjin për gjendjen civile, Kodin Civil, Kodin Penal, Kodin e Punës dhe aktet e tjera që rregullojnë marrëdhënie të posaçme juridike. Për qëllime të këtij Opinioni *Amicus Curiae*, analiza duhet të nisët nga dallimi themelor ndërmjet konfliktit real normativ dhe përdorimit funksional të një termi në fusha të ndryshme të së drejtës.

Në një rend juridik kompleks, i njëjti term mund të përdoret në kontekste të ndryshme dhe të marrë kuptim funksional sipas objektit të ligjit ku vendoset. Kjo nuk përbën në vetvete pasiguri juridike dhe as konflikt normativ. Ajo që kërkohet nga parimi i shtetit të së drejtës është që norma të jetë e

kuptueshme, e zbatueshme, jo kontradiktore dhe e interpretueshme në mënyrë racionale. Shteti i së drejtës nuk kërkon uniformitet absolut terminologjik në çdo akt normativ, por koherencë funksionale ndërmjet normave dhe qartësi të mjaftueshme për subjektet që u drejtohen ato.

Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 duhet lexuar sipas objektit të tij të posaçëm. Ai është ligj horizontal për barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike. Ai nuk është ligj për gjendjen civile, nuk është ligj për marrëdhëniet familjare, nuk është akt që përcakton statusin personal të individit dhe nuk është akt penal. Për rrjedhojë, termat që përdor ligji duhet të kuptohen në funksion të fushës së tij: identifikimit dhe korrigjimit të pabarazive që burojnë nga rolet, stereotipet, pritshmëritë dhe barrierat shoqërore që prekin gratë dhe burrat.

- Mungesa e konfliktit me Kodin e Familjes

Kodi i Familjes rregullon marrëdhëniet familjare, martesën, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve, marrëdhëniet prindërore, përgjegjësinë prindërore, kujdestarinë, birësimin dhe çështje të tjera që lidhen me organizimin juridik të familjes. Ligji nr. 64/2025 nuk ndërhyt në asnjë nga këto institute. Ai nuk ndryshon kushtet e lidhjes së martesës, nuk ndryshon pasojat juridike të martesës, nuk prek regjimin e prindërisë, nuk modifikon të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve dhe nuk krijon kategori të reja familjare.

Përdorimi i termit “gjini” në ligjin për barazinë gjinore nuk ndryshon kuptimin juridik të gruas, burrit, nënës, babait, bashkëshortit, bashkëshortes apo fëmijës në Kodin e Familjes. Këto kategori vijojnë të rregullohen nga legjislacioni familjar sipas objektit të tij. Ligji nr. 64/2025 nuk ka efekt shfuqizues, ndryshues ose zëvendësues ndaj Kodit të Familjes.

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, për të pasur konflikt normativ do të duhej që ligji nr. 64/2025 të parashikonte një rregull të papajtueshëm me Kodin e Familjes, të ndryshonte drejtpërdrejt një institut familjar, ose ta bënte të pazbatueshme një dispozitë të Kodit të Familjes. Një gjë e tillë nuk ndodh. Ligji për barazinë gjinore vepron në një plan tjetër: në planin e politikave publike, të masave kundër diskriminimit dhe të mekanizmave institucionalë për barazi.

Në këtë aspekt, barazia gjinore nuk është në kundërshtim me familjen. Përkundrazi, ajo mund të shërbejë si instrument për forcimin e marrëdhënieve familjare mbi bazën e dinjitetit, respektit, ndarjes së drejtë të përgjegjësisë dhe mbrojtjes nga dhuna e diskriminimi. Një ligj që kërkon të luftojë stereotipet dhe pabarazitë në ndarjen e përgjegjësisë familjare nuk ndërhyt në institutin juridik të familjes; ai kontribuon në krijimin e kushteve që familja të funksionojë në mënyrë më të drejtë dhe më të barabartë.

- Mungesa e konfliktit me ligjin për gjendjen civile

Ligji për gjendjen civile ka objekt regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të gjendjes civile, përfshirë elementët identifikues të personit, aktet e lindjes, martesës, vdekjes dhe të dhëna të tjera të përcaktuara nga ligji. Ky ligj ka funksion identifikues, regjistruues dhe administrativ.

Ligji nr. 64/2025 nuk ndryshon regjistrat e gjendjes civile, nuk përcakton rregulla të reja për regjistrimin e lindjes, martesës apo të dhënave personale, nuk ndryshon procedurat administrative

të gjendjes civile dhe nuk krijon kategori të reja regjistrimi. Për rrjedhojë, nuk mund të konkludohet se ekziston konflikt ndërmjet ligjit për barazinë gjinore dhe ligjit për gjendjen civile.

Dallimi që duhet bërë është ndërmjet kategorive identifikuese në regjistrat publikë dhe kategorive analitike të politikave të barazisë. Në një ligj për gjendjen civile, termat kanë funksion administrativ dhe identifikues. Në një ligj për barazinë gjinore, termi “gjini” ka funksion analitik dhe normativ për të kuptuar pabarazitë shoqërore. Këto funksione janë të ndryshme dhe bashkëjetojnë pa konflikt.

Për këtë arsye, përdorimi i termit “gjini” në ligjin nr. 64/2025 nuk prek sigurinë juridike të regjistrave civilë dhe nuk krijon paqartësi operative për administratën e gjendjes civile. Ligji nuk i drejtohet kësaj fushe dhe nuk prodhon efekte juridike mbi të.

- Mungesa e konfliktit me Kodin Civil dhe të drejtën private

Kodi Civil rregullon zotësinë juridike, zotësinë për të vepruar, marrëdhëniet pasurore, kontraktore, detyrimet, të drejtat reale, trashëgiminë dhe institute të tjera të së drejtës private. Ligji nr. 64/2025 nuk ndryshon asnjë nga këto institute dhe nuk krijon një regjim të ri të zotësisë juridike apo të personalitetit juridik.

Nga kjo pikëpamje, ligji për barazinë gjinore nuk ndërhyt në marrëdhëniet civile të individëve dhe nuk ndryshon mënyrën se si personat fitojnë, ushtrojnë ose humbasin të drejta civile. Ai nuk prek kontratat, pronësinë, trashëgiminë, përgjegjësinë civile ose zotësinë për të vepruar. Dispozitat e tij kanë karakter kryesisht publik, institucional dhe politikëbërës.

Nëse ligji nr. 64/2025 kërkon që politikën, programet ose shërbimet të marrin në konsideratë perspektivën gjinore, kjo nuk do të thotë se ai ndryshon të drejtën private. Kjo do të thotë se shteti dhe institucionet përgjegjëse duhet të sigurohen që masat publike të mos riprodhojnë pabarazi dhe të ofrojnë mundësi të barabarta. Ky është funksion i zakonshëm i legjislacionit për barazinë dhe mosdiskriminimin.

- Mungesa e konfliktit me Kodin Penal

Kodi Penal përdor termat dhe kategoritë e veta në funksion të përcaktimit të veprave penale, përgjegjësisë penale, dënimeve dhe mbrojtjes penale të rendit juridik. Ligji nr. 64/2025 nuk ndryshon përkufizimet penale, nuk krijon vepra të reja penale, nuk ndryshon elementët e figurës së veprës penale dhe nuk ndërhyt në regjimin e përgjegjësisë penale.

Për rrjedhojë, nuk ekziston konflikt normativ ndërmjet ligjit nr. 64/2025 dhe Kodit Penal. Fakti që ligji për barazinë gjinore përdor koncepte si “dhunë me bazë gjinore”, “stereotipe gjinore” ose “barazi gjinore” nuk ndryshon mënyrën se si Kodi Penal përcakton veprat penale dhe përgjegjësinë penale. Këto koncepte kanë funksion politikëbërës, parandalues dhe institucional në ligjin për barazinë gjinore, ndërsa në Kodin Penal termat përdoren për qëllime ndëshkuese dhe garantuese të parimit të ligjshmërisë penale.

Në të drejtën penale, kërkesa për qartësi dhe përcaktueshmëri është veçanërisht e lartë, sepse lidhet me parimin nullum crimen, nulla poena sine lege. Por kjo kërkesë nuk mund të transferohet mekanikisht mbi çdo term të përdorur në ligje jopenale që nuk krijojnë përgjegjësi penale. Ligji

nr. 64/2025 nuk vendos dënime penale dhe nuk përcakton krime. Prandaj, analiza e qartësisë së tij duhet bërë në raport me funksionin administrativ, institucional dhe rregullator që ai ka.

- Raporti me Kodin e Punës dhe legjislacionin e punësimit

Ndryshe nga fushat ku ligji nr. 64/2025 nuk ndërhyr fare, me legjislacionin e punës ai ka një raport plotësues dhe harmonizues. Kodi i Punës dhe aktet përkatëse tashmë njohin parimin e mosdiskriminimit, mbrojtjen e grave shtatzëna, mbrojtjen nga ngacmimi, barazinë në marrëdhëniet e punës dhe detyrimin për kushte të drejta pune. Ligji për barazinë gjinore nuk i zëvendëson këto rregulla, por krijon kornizë të përgjithshme për t'i bërë ato më efektive.

Pabarazitë gjinore në tregun e punës shpesh nuk burojnë nga mungesa formale e një dispozite ndaluese, por nga praktika të fshehta ose strukturore: hendeku i pagave, penalizimi i amësisë, ndarja gjinore e profesioneve, përfaqësimi i ulët i grave në pozicione drejtuese, mungesa e masave për balancën punë-jetë dhe stereotipet mbi rolet familjare. Ligji nr. 64/2025 i adreson këto çështje në nivel horizontal, pa cenuar rregullat e posaçme të Kodit të Punës.

Ky raport është tipik për ligjet e barazisë. Ato nuk zëvendësojnë legjislacionin sektorial, por vendosin parime udhëheqëse dhe mekanizma që duhet të merren parasysh në zbatimin dhe zhvillimin e tij. Për rrjedhojë, raporti ndërmjet ligjit nr. 64/2025 dhe Kodit të Punës është raport komplementar, jo konfliktual.

- Raporti me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi është një nga aktet më të rëndësishme sektoriale me të cilat ligji nr. 64/2025 ndërvepron drejtpërdrejt. Ky ligj parashikon ndalimin e diskriminimit për një gamë të gjerë shkaqesh dhe ka njohur koncepte si diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial dhe mbrojtja efektive nga sjelljet diskriminuese.

Ligji nr. 64/2025 nuk bie ndesh me këtë kuadër. Përkundrazi, ai e plotëson atë duke u fokusuar në një fushë të veçantë: barazinë gjinore. Ndërsa ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka karakter të përgjithshëm dhe ofron mekanizma mbrojtjeje kundër diskriminimit, ligji nr. 64/2025 krijon mekanizma politikëbërës, institucionale dhe parandalues për barazinë gjinore në shoqëri.

Në këtë kuptim, koncepti i “përkatësisë së shumëfishtë” ose i diskriminimit të shumëfishtë nuk krijon paqartësi, por reflekton zhvillimin ekzistues të legjislacionit shqiptar kundër diskriminimit. Ai tregon se një person mund të përballet me pabarazi për shkak të ndërthurjes së disa karakteristikave, si gjinia, mosha, aftësia e kufizuar, etnia, vendbanimi, gjendja ekonomike ose statusi familjar. Ky koncept nuk ndryshon gjininë e askujt dhe nuk krijon kategori civile të reja; ai shërben për të kuptuar më saktë mënyrën se si diskriminimi shfaqet në praktikë.

Nga analiza e mësipërme rezulton se ligji nr. 64/2025 nuk krijon konflikt normativ me legjislacionin sektorial shqiptar. Ai nuk ndryshon Kodin e Familjes, nuk ndërhyr në ligjin për gjendjen civile, nuk prek Kodin Civil, nuk modifikon Kodin Penal dhe nuk zëvendëson Kodin e Punës ose ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Përkundrazi, ai funksionon si një ligj horizontal që plotëson dhe orienton politikat publike drejt realizimit efektiv të barazisë gjinore.

Termi “gjini” në këtë ligj ka kuptim funksional dhe kontekstual. Ai shërben për të analizuar dhe korrigjuar pabarazitë që burojnë nga rolet, stereotipet dhe barrierat shoqërore, pa ndryshuar kategoritë juridike të statusit civil, familjes, martesës, prindërisë ose përgjegjësisë penale. Kjo është në përputhje me teknikën moderne legjislative, me parimin e interpretimit sistematik dhe me standardet ndërkombëtare të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Për rrjedhojë, në ndihmë të Gjykatës Kushtetuese, ky opinion vlerëson se ligji nr. 64/2025 duhet interpretuar në harmoni me legjislacionin sektorial dhe jo si akt që krijon kundërshti me të. Në mungesë të një dispozite konkrete që ndryshon, shfuqizon ose bën të pazbatueshme një normë sektoriale, nuk ka bazë për të konkluduar konflikt normativ. Ligji për barazinë gjinore përfaqëson një zhvillim të ligjshëm të rendit juridik shqiptar dhe një instrument të nevojshëm për realizimin efektiv të barazisë, dinjitetit dhe mosdiskriminimit.

VII.

Koherenca sistemike dhe interpretimi harmonizues

Për Gjykatën Kushtetuese, një parim me rëndësi të veçantë në vlerësimin e raporteve ndërmjet akteve normative është interpretimi sistematik dhe harmonizues i rendit juridik. Kushtetuta, ligjet organike, kodet dhe ligjet e zakonshme nuk duhet të lexohen si akte të izoluara, por si pjesë e një sistemi të vetëm normativ, ku secila normë ka objektin, funksionin dhe fushën e vet të zbatimit. Për këtë arsye, kur dy ose më shumë norma mund të interpretohen në mënyrë që të bashkëjetojnë pa kundërshti, duhet të preferohet interpretimi që ruan koherencën e rendit juridik, përpara se të arrihet në përfundimin se ekziston konflikt normativ.

Ky parim është i lidhur ngushtë me shtetin e së drejtës dhe sigurinë juridike. Një rend juridik funksional nuk kërkon që çdo term të ketë kuptim identik në çdo akt normativ, por kërkon që normat të jenë të qarta në kontekstin e tyre, të zbatueshme dhe të lexueshme në harmoni me njëra-tjetrën. Në këtë kuptim, interpretimi kushtetues duhet të shmangë përplasjet artificiale ndërmjet ligjeve, sidomos kur këto përplasje nuk burojnë nga teksti normativ, por nga një lexim i shkëputur i termave nga objekti dhe qëllimi i ligjit.

Në rastin konkret, ligji nr. 64/2025 mund dhe duhet të interpretohet në harmoni me legjislacionin sektorial. Ai nuk shfuqizon dhe nuk ndryshon normat e Kodit të Familjes, ligjit për gjendjen civile, Kodit Civil, Kodit Penal, Kodit të Punës apo akteve të tjera sektoriale. Ai nuk parashikon rregulla të reja për statusin civil, nuk ndryshon institutin e martesës, nuk modifikon prindërinë, kujdestarinë ose përgjegjësinë prindërore, nuk krijon kategori të reja penale dhe nuk ndërhyt në regjistrat publikë. Përkundrazi, ai vepron si ligj horizontal, me funksion orientues dhe plotësues në fushën e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe politikave publike.

Kjo do të thotë se normat e ligjit nr. 64/2025 duhet të lexohen sipas fushës së tyre të zbatimit. Kur ligji përdor termin “gjini”, ai e përdor atë për të analizuar rolet, stereotipet, pritshmëritë dhe barrierat shoqërore që krijojnë pabarazi ndërmjet grave dhe burrave. Ky kuptim nuk zëvendëson kuptimet juridike që përdoren në ligjet e statusit civil, familjes, shëndetit, punësimit ose së drejtës penale. Në të drejtën e gjendjes civile, termat kanë funksion identifikues dhe regjistruar; në të drejtën familjare, kanë funksion rregullues të marrëdhënieve familjare; në të drejtën penale, kanë

funksion garantues në përcaktimin e përgjegjësisë penale. Në ligjin për barazinë gjinore, i njëjti term ose termat e lidhur me të kanë funksion analitik dhe politikëbërës.

Pikërisht ky dallim funksional shmang çdo konflikt normativ. Për të pasur konflikt të vërtetë ndërmjet ligjit nr. 64/2025 dhe legjislacionit sektorial, duhet të ekzistojë një dispozitë konkrete që e bën të pamundur zbatimin e një norme tjetër, që e ndryshon atë në mënyrë të heshtur ose të shprehur, ose që prodhon pasoja juridike të papajtueshme me të. Një gjë e tillë nuk rezulton. Ligji nr. 64/2025 nuk ka dispozita që ndryshojnë Kodin e Familjes, nuk cenon ligjin për gjendjen civile, nuk krijon përplasje me Kodin Civil, nuk ndryshon elementët e veprave penale dhe nuk përjashton zbatimin e Kodit të Punës. Prandaj, nuk kemi konflikt normativ, por bashkëjetesë të ligjeve me funksione të ndryshme.

Interpretimi harmonizues është i rëndësishëm edhe për të shmangur një lexim që do ta zgjeronte artificialisht fushën e zbatimit të ligjit nr. 64/2025 përtej objektit të tij. Një ligj për barazinë gjinore nuk mund të lexohet sikur të ishte ligj për gjendjen civile, për martesën, për prindërinë ose për përgjegjësinë penale. Një interpretim i tillë do të krijonte një konflikt të sajuar, duke i atribuar ligjit efekte që ai nuk i ka. Gjykata Kushtetuese, në ushtrimin e kontrollit abstrakt të normës, duhet të vlerësojë efektet juridike reale të normës dhe jo pasojat hipotetike që nuk burojnë nga teksti i saj.

Ky interpretim është në përputhje edhe me parimin e sigurisë juridike. Siguria juridike nuk cenohet kur një ligj horizontal përdor koncepte të përshtatshme për objektin e vet, për sa kohë që ato janë të përkufizuara, të kuptueshme dhe të zbatueshme brenda fushës së ligjit. Përkundrazi, siguria juridike forcohet kur secili ligj lexohet sipas qëllimit dhe funksionit të vet. Në këtë mënyrë, ligjet sektoriale ruajnë objektin e tyre, ndërsa ligji për barazinë gjinore plotëson sistemin me parime dhe mekanizma të përgjithshëm për realizimin e barazisë.

Në këtë drejtim, ligji nr. 64/2025 duhet parë si një akt që ndërvepron me legjislacionin sektorial, jo si akt që e zëvendëson atë. Ai ofron një kornizë të përgjithshme që mund të orientojë politikat publike në arsim, punësim, shëndetësi, media, mbrojtje sociale dhe administratë publike, por pa marrë përsipër të rregullojë drejtpërdrejt institutet e posaçme të këtyre fushave. Raporti i tij me ligjet sektoriale është raport plotësues dhe harmonizues: ligjet sektoriale rregullojnë marrëdhëniet konkrete, ndërsa ligji për barazinë gjinore vendos standardin horizontal të barazisë dhe mosdiskriminimit që duhet të udhëheqë politikat dhe zbatimin institucional.

Një lexim i kundërt, që do ta paraqiste çdo përdorim të termit “gjini” si ndërhyrje në legjislacionin familjar, civil apo penal, do të ishte metodologjikisht i pasaktë. Ai do të ngatërronte planin e politikave të barazisë me planin e statusit juridik personal. Këto dy plane bashkëjetojnë në çdo rend juridik modern. Shteti mund të ketë rregulla të veçanta për gjendjen civile dhe, njëkohësisht, politika të barazisë gjinore që analizojnë rolet dhe stereotipet shoqërore. Njëra nuk e përjashton tjetrën.

Për më tepër, interpretimi harmonizues është edhe mënyra më e përshtatshme për të respektuar vullnetin e ligjvënësit. Kur Kuvendi miraton një ligj horizontal për barazinë gjinore pa ndryshuar shprehimisht ligjet sektoriale, prezumohet se ligji i ri synon të veprojë brenda fushës së vet dhe në harmoni me pjesën tjetër të rendit juridik. Vetëm një dispozitë e qartë dhe e papajtueshme do të

mund të sillte përfundimin se ka konflikt. Në mungesë të saj, interpretimi që ruan koherencën sistematike duhet të ketë përparësi.

Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese mund të mbështetet në një lexim pajtues të ligjit nr. 64/2025: termi “gjinë” dhe nocionet e lidhura me të përdoren vetëm për qëllimet e barazisë, mosdiskriminimit, integritetit gjinor dhe politikave publike; ato nuk kanë efekt mbi regjimin e gjendjes civile, martesës, prindërisë, përgjegjësisë penale ose instituteve të tjera sektoriale. Ky interpretim është i qëndrueshëm me tekstin e ligjit, me qëllimin e tij dhe me parimin e sigurisë juridike.

Për rrjedhojë, koherenca sistematike e rendit juridik nuk cenohet nga ligji nr. 64/2025. Përkundrazi, ajo forcohet, sepse rendi juridik pajiset me një instrument horizontal që i ndihmon ligjet sektoriale dhe politikat publike të zbatohen në mënyrë më të ndjeshme ndaj barazisë dhe mosdiskriminimit. Në vend që të krijojë përplasje normative, ligji shërben si urë lidhëse ndërmjet parimeve kushtetuese të barazisë, dinjitetit dhe drejtësisë shoqërore dhe zbatimit konkret të tyre në fusha të ndryshme të jetës publike.

VIII

Liria e shprehjes, media dhe gjuha me ndjeshmëri gjinore

Një çështje tjetër që kërkon vlerësim kushtetues lidhet me raportin ndërmjet ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” dhe lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe përdorimit të gjuhës me ndjeshmëri gjinore. Në këtë drejtim, analiza duhet të nisë nga dallimi ndërmjet, nga njëra anë, lirisë individuale për të menduar, shprehur opinione, marrë pjesë në debat publik dhe ushtruar veprimtari mediatike, dhe nga ana tjetër, detyrimin të shtetit për të ndërtuar një komunikim publik institucional që respekton dinjitetin, barazinë dhe mosdiskriminimin.

Ligji nr. 64/2025 nuk ndalon opinione, nuk kriminalizon mendime, nuk parashikon censurë paraprake dhe nuk vendos një ortodoksi ideologjike mbi qytetarët, median apo debatin publik. Ai nuk përcakton se cilat mendime janë të lejueshme dhe cilat jo, nuk ndalon kritikën ndaj ligjit, ndaj politikave publike ose ndaj koncepteve të barazisë gjinore, dhe nuk krijon mekanizma të kontrollit paraprak mbi përmbajtjen e shprehjes. Përkundrazi, dispozitat që lidhen me gjuhën me ndjeshmëri gjinore duhet të lexohen si standarde të komunikimit publik jo-diskriminues, veçanërisht për institucionet publike dhe subjektet që ofrojnë shërbime me interes publik.

Në një shoqëri demokratike, shteti ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë që komunikimi zyrtar, informacioni publik, dokumentet institucionale, politikat publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve të përdorin gjuhë të qartë, të kuptueshme, të aksesueshme dhe jo-diskriminuese. Kjo nuk përbën censurë, por standard administrativ i qeverisjes së mirë, i barazisë dhe i respektit për dinjitetin e çdo personi. Ashtu si administrata publike mund të detyrohet të përdorë gjuhë të thjeshtë, gjuhë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, apo gjuhë që shmang terminologjinë raciste ose denigruese, ajo mund të orientohet edhe drejt përdorimit të gjuhës që shmang stereotipet gjinore dhe përjashtimin.

a. Liria e shprehjes sipas nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ

Neni 22 i Kushtetutës garanton lirinë e shprehjes, ndërsa neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbron lirinë e mendimit, të marrjes dhe dhënies së informacionit dhe ideve pa ndërhyrje nga autoritetet publike. Këto garanci janë themelore për rendin demokratik, pluralizmin dhe debatin publik. Megjithatë, liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute. Ajo bashkëjeton me detyrimin për të mbrojtur dinjitetin, reputacionin, të drejtat e të tjerëve, sigurinë publike, rendin demokratik dhe parandalimin e diskriminimit.

Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është pranuar se shtetet gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të vendosur masa të nevojshme dhe proporcionale kur shprehja cenon të drejtat e të tjerëve, përhap urrejtje, nxit paragjykim ose krijon mjedis diskriminues. Në çështjen **Vejdeland and Others v. Sweden**, Gjykata pranoi ndërhyrjen ndaj shpërndarjes së materialeve denigruese ndaj personave LGBT, duke theksuar se shprehjet që përhapin paragjykim dhe intolerancë mund të kufizohen në mënyrë legjitime kur masat janë proporcionale (2012, §§47–55). Po kështu, në **Delfi AS v. Estonia**, Gjykata theksoi se hapësira mediatike dhe ajo digjitale nuk janë zona pa përgjegjësi dhe se mbrojtja nga gjuha dëmtuese mund të justifikojë detyrime të caktuara për platformat dhe mediat, në varësi të kontekstit (GC, 2015, §§131–162).

Këto standarde nuk përdoren për të justifikuar kufizim të debatit publik, por për të treguar se liria e shprehjes nuk e përjashton detyrimin e shtetit për të mbrojtur personat nga diskriminimi, stereotipizimi denigrues dhe gjuha që cenon dinjitetin. Prandaj, një ligj që kërkon komunikim institucional të barabartë dhe jo-diskriminues nuk bie automatikisht në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës ose nenin 10 të KEDNJ-së. Vlerësimi kushtetues duhet të fokusohet nëse masa vendos ndalim të shprehjes, censurë, sanksion disproporcional ose kontroll të papajtueshëm mbi debatin publik. Në rastin e ligjit nr. 64/2025, një efekt i tillë nuk rezulton.

b. Gjuha me ndjeshmëri gjinore si standard institucional dhe jo si censurë

Dispozitat e ligjit nr. 64/2025 për gjuhën me ndjeshmëri gjinore duhet të lexohen në kontekstin e objektit të ligjit: barazia gjinore, mosdiskriminimi dhe integrimi i perspektivës gjinore në jetën institucionale dhe publike. Ato nuk ndalojnë përdorimin e fjalëve të caktuara nga qytetarët, nuk parashikojnë sanksione penale për mendime, nuk vendosin filtra paraprakë mbi publikimet dhe nuk e kufizojnë debatin akademik, politik, fetar, kulturor ose mediatik mbi çështjet gjinore.

Në thelb, kërkesa për gjuhë me ndjeshmëri gjinore është një standard i komunikimit publik që synon të shmangë formulime përjashtuese, stereotipike ose denigruese në dokumentet dhe mesazhet institucionale. Ajo ka funksion të ngjashëm me standardet për gjuhë të qartë administrative, gjuhë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, komunikim të përshtatshëm për fëmijët, ose shmangie të terminologjisë diskriminuese ndaj grupeve etnike, fetare, shoqërore apo personave me aftësi të kufizuara. Të gjitha këto janë pjesë e administrimit demokratik dhe nuk përbëjnë censurë.

Nga pikëpamja kushtetuese, gjuha institucionale nuk është një hapësirë krejtësisht neutrale. Mënyra se si shteti komunikon me qytetarët mund të përfshijë ose të përjashtojë; mund të forcojë stereotipe ose t'i zbusë ato; mund të jetë e aksesueshme ose e paarritshme për kategori të caktuara. Për këtë arsye, ligjvënësi mund të kërkojë që institucionet publike të komunikojnë në mënyrë që

respekton barazinë dhe dinjitetin e të gjithë personave. Kjo është pjesë e detyrimit pozitiv të shtetit për të kontribuar në realizimin e të drejtave themelore.

Për më tepër, gjuha me ndjeshmëri gjinore nuk kërkon uniformitet të mendimit dhe nuk e zëvendëson pluralizmin. Ajo nuk i detyron qytetarët të mbajnë një qëndrim të caktuar ideologjik mbi çështjet gjinore. Ajo kërkon që institucionet publike, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të shmangin gjuhën që riprodhon stereotipe, përjashton gratë ose burrat nga fusha të caktuara, ose normalizon pabarazi në komunikimin zyrtar. Ky është dallimi thelbësor ndërmjet rregullimit të komunikimit institucional dhe censurës së shprehjes individuale.

c. Standardet ndërkombëtare dhe praktika krahasuese mbi gjuhën jo-diskriminuese

Koncepti i gjuhës me ndjeshmëri gjinore është i njohur në të drejtën ndërkombëtare, në praktikat administrative krahasuese dhe në dokumentet e organizatave ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara kanë zhvilluar udhëzime për përdorimin e gjuhës me ndjeshmëri gjinore në komunikimin institucional, duke synuar shmangien e formulimeve stereotipike dhe përdorimin e shprehjeve që reflektojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në shoqëri. Po kështu, Parlamenti Evropian ka hartuar udhëzime për gjuhën me ndjeshmëri gjinore, ndërsa Këshilli i Evropës ka promovuar prej kohësh përdorimin e gjuhës jo-seksiste në administratë, arsim dhe komunikim publik.

Këto standarde nuk janë konceptuar si kufizime të lirisë së shprehjes, por si mjete për të përmirësuar cilësinë, gjithëpërfshirjen dhe paanshmërinë e komunikimit publik. Në shumë shtete evropiane, administratat publike, universitetet, parlamentet, institucionet e drejtësisë dhe organet rregullatore përdorin udhëzues të tillë pa u konsideruar se cenojnë lirinë e shprehjes. Përkundrazi, ato konsiderohen elemente të profesionalizmit institucional, barazisë dhe respektit për qytetarët.

Kjo praktikë është relevante për Gjykatën Kushtetuese, sepse tregon se standardet për gjuhë me ndjeshmëri gjinore janë të pajtueshme me demokracinë pluraliste, për sa kohë ato nuk shndërrohen në mjete ndëshkuese disproporcionale ose censurë. Në ligjin nr. 64/2025, këto standarde kanë karakter orientues dhe institucional; ato synojnë të përmirësojnë komunikimin publik dhe jo të mbyllin debatin.

d. Media, pluralizmi dhe përgjegjësia në raportim

Liria e medias është pjesë thelbësore e lirisë së shprehjes dhe një garanci e domosdoshme për demokracinë. Çdo ndërhyrje në fushën e medias duhet të interpretohet me kujdes dhe në përputhje me standardet e nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ-së. Megjithatë, liria e medias nuk përjashton standardet profesionale dhe përgjegjësinë për të shmangur gjuhën diskriminuese, seksiste, objektivizuese ose nxitëse të urrejtjes.

Dispozitat e ligjit nr. 64/2025 që u referohen ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive dhe shtypit nuk mund të lexohen si censuruese. Ato nuk krijojnë kontroll paraprak mbi përmbajtjen, nuk ndalojnë trajtimin kritik të çështjeve gjinore, nuk pengojnë pluralizmin editorial dhe nuk imponojnë një narrativë të vetme. Ato vendosin një standard të përgjithshëm që media, si aktor me ndikim të madh publik, të kontribuojë në shmangien e gjuhës seksiste dhe stereotipeve gjinore, në përputhje me dinjitetin dhe të drejtat e personave që preken nga raportimi.

Ky standard është i njohur edhe në kuadrin rregullator shqiptar. Kodi i Transmetimit Audioviziv, i miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 60/2023, ka integruar më parë terminologji dhe standarde të ngjashme. Ai njeh koncepte të tilla si “dhunë me bazë gjinore”, “identitet gjinor” dhe “stereotip gjinor”, duke e vendosur raportimin mediatik në raport me realitetet shoqërore që lidhen me gjininë. Seksioni nr. 5 i këtij Kodi, “Parandalimi e luftimi i diskriminimit gjinor dhe promovimi i barazisë gjinore”, parashikon detyrimin për operatorët e shpërndarjes mediatike audiovizive që të përdorin gjuhë të ndjeshme gjinore, jo-seksiste dhe jo-diskriminuese për shkak të gjinisë.

Ky fakt ka rëndësi kushtetuese sepse tregon se ligji nr. 64/2025 nuk fut një standard të papritur ose të panjohur në rendin juridik shqiptar. Përkundrazi, ai e vendos në një kuadër horizontal një standard që tashmë është pranuar në sektorin audioviziv. Në këtë kuptim, ligji nuk e ndryshon natyrën e lirisë së medias dhe as nuk e dobëson pluralizmin. Ai e lidh ushtrimin e komunikimit publik dhe mediatik me detyrimin për respektimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

dh. Përkatësia e shumëfishtë dhe “gratë dhe burrat në të gjithë diversitetin e tyre”

Në kontekstin e lirisë së shprehjes dhe gjuhës me ndjeshmëri gjinore, është e rëndësishme të sqarohet edhe përdorimi i koncepteve si “përkatësi e shumëfishtë” ose shprehja “gra dhe burra në të gjithë diversitetin e tyre”. Këto nuk janë formula ideologjike të paqarta dhe as kategori që synojnë të zëvendësojnë kuptimet juridike ekzistuese. Ato janë mjete për të njohur se gratë dhe burrat nuk janë grupe homogjene dhe se pabarazia mund të shfaqet ndryshe në varësi të moshës, aftësisë së kufizuar, etnisë, vendbanimit, gjendjes ekonomike, statusit familjar ose faktorëve të tjerë.

Koncepti i diskriminimit të shumëfishtë është tashmë i njohur në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi, pas ndryshimeve të vitit 2020. Ai nënkupton se një person mund të përballë me trajtim të pafavorshëm për shkak të dy ose më shumë shkaqeve diskriminimi që ndërthuren ose veprojnë njëkohësisht. Njohja e kësaj forme diskriminimi nuk krijon paqartësi në rendin juridik; përkundrazi, e bën mbrojtjen më efektive dhe më të përshtatur me realitetin shoqëror.

Në praktikë, një grua rome mund të përballë njëkohësisht me diskriminim për shkak të gjinisë dhe përkatësisë etnike; një grua me aftësi të kufizuara mund të përballë me pengesa që lidhen si me gjininë, ashtu edhe me aftësinë e kufizuar; një burrë i moshuar në kushte varfërie mund të përballë me një kombinim të moshës, statusit ekonomik dhe stereotipeve gjinore. Këto situata nuk mund të kuptohen plotësisht nëse ligji njeh vetëm forma të izoluara diskriminimi.

Po kështu, shprehja “gra dhe burra në të gjithë diversitetin e tyre” nuk krijon kategori të reja juridike. Ajo thjesht njeh se politikat publike duhet të jenë të ndjeshme ndaj dallimeve brenda grupeve. Nevojat e grave rurale nuk janë gjithmonë të njëjta me ato të grave urbane; pengesat e grave me aftësi të kufizuara nuk janë të njëjta me ato të grave pa aftësi të kufizuara; problemet e burrave të rinj në tregun e punës mund të ndryshojnë nga ato të burrave të moshuar. Një politikë publike racionale duhet t’i marrë parasysh këto dallime.

Ky sqarim është i rëndësishëm, sepse përdorimi i këtyre koncepteve nuk cenon lirinë e shprehjes dhe as nuk imponon një mënyrë të vetme të menduarit. Ato janë kategori të politikëbërjes dhe të mbrojtjes nga diskriminimi, jo instrumente censuruese.

e. Testi i proporcionalitetit në raport me lirinë e shprehjes dhe medias

Edhe nëse dispozitat e ligjit për gjuhën me ndjeshmëri gjinore do të konsideroheshin si një formë ndërhyrjeje në mënyrën e komunikimit institucional ose mediatik, ato do të përmbushnin testin kushtetues të proporcionalitetit. Së pari, ndërhyrja është e parashikuar me ligj. Së dyti, ndjek një qëllim legjitim: mbrojtjen e barazisë, dinjitetit njerëzor, mosdiskriminimit dhe të drejtave të tjerëve. Së treti, është e përshtatshme për të arritur këtë qëllim, sepse gjuha publike dhe mediatike ndikon në mënyrën se si shoqëria percepton rolet, mundësitë dhe dinjitetin e grave dhe burrave.

Masa është gjithashtu e nevojshme, pasi stereotipet gjinore dhe gjuha diskriminuese nuk janë fenomene abstrakte. Ato ndikojnë në normalizimin e pabarazive, në mënyrën se si paraqiten gratë dhe burrat në media, në aksesin në informacion dhe në trajtimin e personave në institucionet publike. Një standard për gjuhë të ndjeshme gjinore është një mjet më pak kufizues sesa masa ndëshkuese të rënda; ai synon orientim, parandalim dhe profesionalizim të komunikimit.

Së fundi, ruhet një ekuilibër i drejtë ndërmjet qëllimit publik dhe lirisë së shprehjes. Ligji nuk ndalon debatin publik, nuk kufizon kritikën, nuk vendos censurë paraprake dhe nuk parashikon kontroll ideologjik. Ai synon që komunikimi institucional dhe mediatik të mos kontribuojë në diskriminim ose stereotipizim. Për rrjedhojë, masa është proporcionale në raport me qëllimin e mbrojtjes së barazisë dhe dinjitetit.

f. Pasojat e një interpretimi tepër të gjerë të lirisë së shprehjes

Nëse çdo standard institucional për gjuhë jo-diskriminuese do të konsiderohej kufizim i papranueshëm i lirisë së shprehjes, shteti nuk do të mund të kërkonte as gjuhë jo-raciste, as komunikim të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, as terminologji profesionale në administratë, as shmangie të gjuhës denigruese në shërbimet publike. Një përfundim i tillë do të ishte i papajtueshëm me funksionimin e një administrate demokratike, me detyrimet pozitive të shtetit dhe me standardet bashkëkohore të të drejtave të njeriut.

Liria e shprehjes nuk mund të interpretohet si e drejtë për të kërkuar që shteti të përdorë gjuhë diskriminuese, përjashtuese ose stereotipike në komunikimin e tij zyrtar. Qytetarët, media, akademja, shoqëria civile dhe aktorët politikë mbeten të lirë të debatojnë, kritikojnë dhe mbajnë qëndrime të ndryshme. Por institucionet publike, kur flasin në emër të shtetit dhe ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët, kanë detyrim më të lartë për neutralitet, përfshirje, respekt dhe mosdiskriminim.

Ky dallim është thelbësor për ruajtjen e ekuilibrit kushtetues. Ligji nr. 64/2025 nuk kërkon uniformizim të mendimit shoqëror. Ai kërkon që komunikimi publik institucional të jetë i tillë që nuk përjashton, nuk nënvlerëson dhe nuk riprodhon stereotipe ndaj grave, burrave apo grupeve që përballen me diskriminim të shumëfishtë.

Nga analiza e mësipërme rezulton se ligji nr. 64/2025 nuk cenon lirinë e shprehjes dhe as lirinë e medias. Ai nuk imponon censurë, nuk ndalon debat publik, nuk kriminalizon opinione dhe nuk vendos kontroll paraprak mbi përmbajtjen e shprehjes. Dispozitat për gjuhë me ndjeshmëri gjinore kanë karakter institucional, profesional dhe parandalues. Ato synojnë komunikim publik të barabartë, gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues.

Në raport me nenin 22 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së, këto dispozita ndjekin qëllim legjitim, janë të përshtatshme dhe proporcionale, dhe nuk cenojnë thelbin e lirisë së shprehjes. Ato janë gjithashtu në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe me kuadrin ekzistues shqiptar të medias, përfshirë Kodin e Transmetimit Audioviziv të AMA-s.

Për rrjedhojë, ky *Amicus Curiae* vlerëson se dispozitat e ligjit nr. 64/2025 mbi gjuhën me ndjeshmëri gjinore dhe komunikimin jo-diskriminues duhet të interpretohen si mekanizma të ligjshëm për realizimin e barazisë dhe dinjitetit, dhe jo si kufizime antikushtetuese të lirisë së shprehjes ose medias.

IX

Instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara dhe epërsia e tyre në rendin shqiptar

Një element thelbësor në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” është raporti i tij me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe me standardet evropiane në fushën e barazisë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore. Në këtë drejtim, analiza kushtetuese nuk mund të kufizohet vetëm në leximin e izoluar të dispozitave të ligjit të brendshëm, por duhet të zhvillohet në harmoni me nenet 5 dhe 122 të Kushtetutës, të cilat e vendosin rendin juridik shqiptar në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme.

Sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Ndërsa neni 122 parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pas botimit në Fletoren Zyrtare, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik, zbatohen drejtpërdrejt kur janë të vetëzbatueshme dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të zakonshme në rast konflikti. Këto dispozita kanë rëndësi të posaçme në këtë çështje, sepse ligji nr. 64/2025 vepron pikërisht në një fushë ku Shqipëria ka marrë detyrime të qarta ndërkombëtare: barazia gjinore, parandalimi i diskriminimit, lufta kundër stereotipeve dhe mbrojtja nga dhuna ndaj grave.

Për këtë arsye, ligji nr. 64/2025 nuk duhet parë si akt i shkëputur nga konteksti ndërkombëtar dhe evropian, por si instrument i brendshëm për zbatimin e detyrimeve që shteti shqiptar ka pranuar në mënyrë sovrane. Ai nuk krijon konflikt me instrumentet ndërkombëtare; përkundrazi, i operacionalizon ato në nivel të së drejtës së brendshme, duke i dhënë administratës, institucioneve publike dhe subjekteve përgjegjëse mekanizma konkretë për realizimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW, është një nga instrumentet themelore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Ajo nuk kufizohet në ndalimin formal të diskriminimit, por kërkon nga shtetet palë të marrin masa aktive për eliminimin e diskriminimit në ligj, në praktikë dhe në strukturat shoqërore që e riprodhojnë atë.

Në këtë kuptim, CEDAW nuk e kupton barazinë si një deklaratë formale, por si rezultat që kërkon masa konkrete. Shteti duhet të veprojë jo vetëm kur diskriminimi është i drejtpërdrejtë dhe i shprehur në ligj, por edhe kur pabarazia buron nga praktika, zakone, modele kulturore, ndarje tradicionale e roleve dhe stereotipe që kufizojnë mundësitë reale të grave dhe vajzave.

Rëndësi të veçantë ka neni 5 i CEDAW, i cili kërkon nga shtetet të ndërmarrin masa për të ndryshuar modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, me qëllim eliminimin e paragjyimeve, praktikave zakonore dhe çdo praktike tjetër të bazuar në idenë e inferioritetit ose superioritetit të njërit seks, ose në role stereotipike për burrat dhe gratë. Kjo dispozitë është thelbësore për çështjen në shqyrtim, sepse tregon se e drejta ndërkombëtare kërkon pikërisht njohjen dhe adresimin e dimensionit social të roleve gjinore.

Pa këtë dimension social, neni 5 i CEDAW do të mbetet i pazbatueshëm. Nuk mund të kërkohej eliminimi i stereotipeve dhe modeleve kulturore të sjelljes, nëse ligji nuk njeh më parë se këto modele ekzistojnë dhe prodhojnë pasoja juridike e shoqërore. Ligji nr. 64/2025, duke përdorur koncepte si “stereotipe gjinore”, “integrim gjinor”, “gjuhë me ndjeshmëri gjinore” dhe masa për barazi efektive, është në harmoni të drejtpërdrejtë me këtë detyrim.

Për rrjedhojë, ligji nr. 64/2025 nuk bie ndesh me CEDAW. Përkundrazi, ai materializon një prej kërkesave qendrore të kësaj Konvente: kalimin nga barazia formale te barazia reale, përmes ndryshimit të praktikave, stereotipeve dhe pengesave strukturore që kufizojnë gratë dhe vajzat në jetën publike, ekonomike, sociale dhe familjare.

Po kështu, **Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje**, e njohur si Konventa e Stambollit, ka rëndësi të posaçme për vlerësimin e ligjit nr. 64/2025. Kjo Konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe është pjesë e rendit të brendshëm juridik sipas nenit 122 të Kushtetutës. Shqipëria e ka pranuar këtë instrument pa rezerva që do të kufizonin zbatimin e përkufizimeve dhe detyrimeve të tij në fushën e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës ndaj grave.

Neni 3, shkronja “c”, i Konventës së Stambollit përkufizon “gjininë” si rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e ndërtuara shoqërisht që një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat. Ky përkufizim është thelbësor, sepse dëshmon se në të drejtën evropiane të të drejtave të njeriut termi “gjini” përdoret si nocion juridiko-social për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet roleve shoqërore dhe pabarazive që mund të çojnë në dhunë, diskriminim dhe nënshtrim.

Për rrjedhojë, përdorimi i të njëjtit kuptim në ligjin nr. 64/2025 nuk mund të konsiderohet devijim nga Kushtetuta ose nga rendi juridik shqiptar. Përkundrazi, ai është shprehje e detyrimit kushtetues për të zbatuar një traktat të ratifikuar. Nëse një nocion është pranuar nga Republika e Shqipërisë përmes ratifikimit të një konvente ndërkombëtare dhe është bërë pjesë e së drejtës së brendshme, ligjvënësi ka hapësirë të plotë, madje detyrim, ta përdorë atë nocion kur miraton akte ligjore në të njëjtën fushë rregullimi.

Konventa e Stambollit nuk ndalet vetëm te përkufizimi i termit “gjini”. Neni 12 i saj kërkon nga shtetet të marrin masa për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me qëllim çrrënjosjen e paragjyimeve, zakoneve, traditave dhe praktikave

të tjera të bazuara në inferioritetin e grave ose në role stereotipike për gratë dhe burrat. Kjo lidhet drejtpërdrejt me mekanizmat e ligjit nr. 64/2025 për luftimin e stereotipeve dhe integrimin gjinor.

Po kështu, neni 14 i Konventës së Stambollit kërkon që shtetet të përfshijnë, aty ku është e përshtatshme, materiale mësimore mbi barazinë ndërmjet grave dhe burrave, rolet jo-stereotipike gjinore, respektin reciprok, zgjidhjen pa dhunë të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale dhe të drejtën për integritet personal. Ndërsa neni 17 kërkon angazhimin e sektorit privat dhe medias në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe në rritjen e respektit për dinjitetin e grave.

Këto dispozita tregojnë se Konventa e Stambollit kërkon një qasje gjithëpërfshirëse: ligjore, institucionale, arsimore, mediatike dhe shoqërore. Ligji nr. 64/2025 ndjek të njëjtën logjikë. Ai nuk kufizohet në shpalljen abstrakte të barazisë, por kërkon mekanizma, politika dhe standarde komunikimi që ndihmojnë në parandalimin e diskriminimit dhe stereotipeve. Kjo e vendos ligjin në harmoni të drejtpërdrejtë me Konventën e Stambollit.

Në vlerësimin kushtetues duhet të mbahet parasysh se Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën e Stambollit pa rezerva që të kufizonin zbatimin e përkufizimit të gjinisë ose të detyrimeve për luftimin e stereotipeve. Kjo ka rëndësi juridike, sepse në të drejtën ndërkombëtare rezervat janë shprehje individuale e vullnetit të shtetit palë dhe kanë efekt vetëm për atë shtet që i ka bërë. Rezervat ose deklaratat interpretative të shteteve të tjera nuk modifikojnë detyrimet e Shqipërisë dhe nuk mund të përdoren për të relativizuar detyrimet që Republika e Shqipërisë ka pranuar vetë. Në momentin që Shqipëria ratifikoi Konventën pa rezerva, ajo pranoi tekstin, objektin dhe qëllimin e saj, përfshirë përkufizimin e “gjinisë”, detyrimin për të luftuar stereotipet dhe kërkesën për masa parandaluese në arsim, media, sektor privat dhe politika publike. Ky element është me rëndësi për Gjykatën Kushtetuese, sepse ligji nr. 64/2025 nuk duhet vlerësuar si akt që importon në mënyrë të papritur një koncept të huaj. Ai duhet parë si mjet i brendshëm për zbatimin e një detyrimi ndërkombëtar të pranuar nga shteti shqiptar. Në këtë kuptim, përdorimi i termit “gjini” nuk është cenim i sovranitetit kushtetues, por ushtrim i tij në përputhje me nenet 5 dhe 122 të Kushtetutës.

Ligji nr. 64/2025 është gjithashtu në harmoni me frymën e **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**. (shih më poshtë analizën e praktikës jurisprudenciale të GJEDNJ). Edhe pse KEDNJ nuk përmban një përkufizim të termit “gjini” të ngjashëm me Konventën e Stambollit, jurisprudenca e Strasburgut ka zhvilluar një qasje të qartë kundër stereotipeve gjinore dhe trajtimeve të bazuara në role tradicionale të grave dhe burrave. Në çështjen Konstantin Markin v. Russia, Gjykata Evropiane ka theksuar se promovimi i barazisë gjinore është një objektiv madhor i shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe se referimi të stereotipet tradicionale mbi rolet e burrave dhe grave nuk mund të justifikojë trajtim të ndryshëm (2012, §127). Ky standard është i rëndësishëm, sepse pranon që barazia efektive kërkon tejkalimin e supozimeve tradicionale për rolet familjare dhe shoqërore. Kjo qasje është në harmoni me ligjin nr. 64/2025. Ligji synon të adresojë pikërisht stereotipet dhe barrierat që kufizojnë mundësitë reale të grave dhe burrave. Për rrjedhojë, ai nuk bie ndesh me standardin e KEDNJ-së, por reflekton evolucionin e jurisprudencës evropiane mbi barazinë dhe mosdiskriminimin.

Për më tepër, **edhe e drejta e Bashkimit Evropian** mbështet qasjen e ligjit nr. 64/2025. Barazia gjinore është parim transversal në rendin juridik të BE-së dhe nuk reduktohet në trajtim formal. Ajo përfshin masa për barazi në punësim, pjesëmarrje në vendimmarrje, transparencë në paga, balancë punë-jetë, mbrojtje të grave shtatzëna dhe luftë kundër dhunës ndaj grave.

Në radhë të parë, ligji është në harmoni me **Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian**, veçanërisht me Kapitullin III mbi barazinë dhe Kapitullin IV mbi solidaritetin. Nenet 20–23 të Kartës sanksionojnë barazinë para ligjit, ndalimin e diskriminimit dhe barazinë ndërmjet grave dhe burrave, duke parashikuar se barazia duhet të sigurohet në të gjitha fushat, përfshirë punësimin, punën dhe pagën. Kjo filozofi reflektohet në ligjin nr. 64/2025, i cili e trajton barazinë gjinore si parim horizontal të politikave publike. Ndërkohë siç referuam më lart, ligji është në harmoni edhe me të drejtën e BE:

Direktiva 2006/54/KE mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim dhe profesion përbën instrument qendror të BE-së në këtë fushë. Ajo konsolidon standardet mbi diskriminimin direkt dhe indirekt, ngacmimin seksual, pagën e barabartë dhe mjetet e zbatimit. Ligji nr. 64/2025, duke forcuar mekanizmat institucionalë dhe duke integruar perspektivën gjinore në politikat publike, lëviz në të njëjtën linjë me këtë direktivë.

Direktiva 2019/1158 për balancën ndërmjet jetës profesionale dhe asaj familjare për prindërit dhe kujdestarët është veçanërisht relevante, sepse ajo bazohet në premisën se pabarazitë gjinore burojnë edhe nga ndarja tradicionale e përgjegjësi të kujdesit familjar. Kur ligji shqiptar promovon ndarje më të drejtë të përgjegjësi, integrim gjinor dhe masa kundër stereotipeve, ai ndjek të njëjtën qasje që përfaqëson kjo direktivë.

Direktiva 2022/2381 mbi përmirësimin e ekuilibrit gjinor në bordet e shoqërive të listuara tregon se vetë Bashkimi Evropian njeh nevojën për masa aktive për të korrigjuar nën-përfaqësimin historik të grave në vendimmarrje ekonomike. Ky është argument i rëndësishëm kundër çdo qasjeje që e redukton barazinë në neutralitet formal. Barazia reale, në standardin evropian, kërkon masa të arsyeshme dhe të synuara për të korrigjuar pengesat strukturore.

Direktiva 2023/970 mbi transparencën e pagave dhe zbatimin e parimit të pagës së barabartë tregon se BE-ja po kalon nga parimet e përgjithshme drejt mekanizmave konkretë të zbatimit për të luftuar hendekun gjinor të pagave. Ligji nr. 64/2025, që kërkon integrim gjinor në politika, institucione dhe mekanizma monitorimi, është në harmoni me këtë zhvillim.

Për më tepër, instrumente të tjera të BE-së, si Direktiva 92/85/KEE mbi mbrojtjen e punëtoreve shtatzëna, grave që kanë lindur së fundmi apo ushqejnë me gjë, Direktiva 79/7/KEE mbi trajtimin e barabartë në sigurimet shoqërore, Direktiva 2010/41/BE mbi trajtimin e barabartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar, si dhe Direktiva 2004/113/KE mbi trajtimin e barabartë në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, dëshmojnë se barazia gjinore në *acquis* shtrihet përtej një fushe të vetme dhe përfshin punën, mbrojtjen sociale, sipërmarrjen, shërbimet dhe jetën ekonomike.

Në të njëjtën linjë, Direktiva 2024/1385 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje tregon se parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave është bërë pjesë qendrore e rendit juridik të BE-së. Ligji nr. 64/2025, duke trajtuar barazinë gjinore si çështje horizontale që përfshin edhe

parandalimin e stereotipeve dhe komunikimin institucional jo-diskriminues, përputhet me këtë zhvillim evropian.

Nga këndvështrimi kushtetues, përputhshmëria e ligjit nr. 64/2025 me instrumentet e BE-së ka rëndësi të veçantë. Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe përafrimi me *acquis* përbën interes publik madhor dhe objektiv strategjik të rendit kushtetues dhe politik të shtetit. Kur një ligj synon harmonizimin e standardeve të barazisë, mbrojtjes sociale, mosdiskriminimit dhe luftës kundër dhunës me të drejtën evropiane, ai gëzon një bazë të fortë legjitimiteti kushtetues. Kjo nuk do të thotë se çdo ligj që synon përafrim me BE-në është automatikisht kushtetues. Gjykata Kushtetuese ruan kompetencën e saj për të verifikuar nëse ligji cenon ndonjë të drejtë themelore ose bie ndesh me Kushtetutën. Megjithatë, në rastin konkret, ku ligji ndjek qëllime kushtetuese dhe ndërkombëtare si barazia, dinjiteti, mosdiskriminimi dhe mbrojtja nga dhuna, orientimi evropian përforcon arsyeshmërinë dhe legjitimitetin e ndërhyrjes ligjore. Do të ishte problematike e kundërta: nëse Shqipëria, ndërkohë që ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare dhe synon përafrimin me *acquis*, nuk do të ndërmernte masa të brendshme për zbatimin e tyre. Mungesa e harmonizimit mund të krijonte boshllëqe normative dhe mospërputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane. Ligji nr. 64/2025 synon pikërisht të shmangë këto boshllëqe.

Sa më sipër, konkludohet se ligji nr. 64/2025 është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe me standardet evropiane të barazisë gjinore. Ai zbaton nenet 5 dhe 122 të Kushtetutës, duke përkthyer në të drejtën e brendshme detyrimet që burojnë nga CEDAW, Konventa e Stambollit, KEDNJ dhe *acquis* i Bashkimit Evropian. Përkundrazi, Ligji nr.64/2025 duhet të cilësohet si një mjet i nevojshëm për zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik shqiptar. Në këtë kuptim, pretendimi për papajtueshmëri me standardet ndërkombëtare ose evropiane duhet të konsiderohet i pambështetur në fakt dhe në të drejtë.

X

Jurisprudenca evropiane relevante

Jurisprudenca evropiane përbën një pikë reference të rëndësishme për shqyrtimin kushtetues të ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, veçanërisht për të kuptuar se si parimi i barazisë gjinore është zhvilluar në rendin juridik evropian. Në këtë drejtim, rëndësi kanë si jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe ajo e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Të dyja këto gjykata, ndonëse veprojnë në sisteme të ndryshme juridike, kanë zhvilluar një qasje të përbashkët: barazia ndërmjet grave dhe burrave nuk mund të reduktohet në trajtim formal identik, por kërkon adresimin e stereotipeve, roleve tradicionale, pengesave strukturore dhe pabarazive reale që ndikojnë në gëzimin efektiv të të drejtave.

Ky standard ka rëndësi të drejtpërdrejtë për Gjykatën Kushtetuese, sepse ligji nr. 64/2025 përdor termin “gjini” dhe konceptet e lidhura me të pikërisht për të identifikuar dhe korrigjuar pabarazitë që burojnë nga rolet, pritshmëritë dhe stereotipet shoqërore. Jurisprudenca evropiane tregon se kjo nuk është shmangie nga standardi i të drejtave të njeriut, por është pjesë e vetë evolucionit të tij.

- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar një linjë të qëndrueshme jurisprudenciale sipas së cilës stereotipet gjinore nuk mund të shërbejnë si bazë për trajtim të ndryshëm dhe as për kufizimin e të drejtave të individëve. Edhe pse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk përmban një përkufizim tekstual të termit “gjinë”, Gjykata e Strasburgut ka trajtuar në mënyrë të përsëritur pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave si të lidhura me role sociale, pritshmëri kulturore dhe ndarje tradicionale të përgjegjësisë.

Kjo qasje është e rëndësishme sepse tregon se, në jurisprudencën e Strasburgut, barazia nuk kuptohet vetëm si krahasim formal ndërmjet individëve, por si mbrojtje kundër modeleve shoqërore që e vendosin një person ose një grup në pozicion disavantazhi. Në këtë kuptim, ligji nr. 64/2025 që synon të luftojë stereotipet dhe pabarazitë gjinore është në përputhje me frymën e Konventës dhe me mënyrën se si ajo interpretohet nga GjEDNJ.

Në çështjen **Konstantin Markin v. Russia** (Dhomë e Madhe, 22 mars 2012), Gjykata trajtoi dallimin në të drejtën për leje prindërore ndërmjet burrave dhe grave në ushtri. Ajo theksoi se supozimet tradicionale sipas të cilave kujdesi për fëmijët është rol natyror i grave, ndërsa burrat duhet të mbeten të përqendruar në aktivitetin profesional, nuk mund të justifikojnë trajtim të ndryshëm. Gjykata deklaroi se referimi të stereotipet gjinore është i papajtueshëm me Konventën dhe se avancimi i barazisë gjinore përbën një qëllim madhor për shtetet evropiane (**Konstantin Markin v. Russia**, 2012, §§127–132).

Ky vendim ka rëndësi të veçantë për shqyrtimin e ligjit nr. 64/2025. Ai tregon se stereotipet mbi rolet familjare të grave dhe burrave nuk janë çështje të thjeshta kulturore jashtë fushës së së drejtës, por mund të prodhojnë diskriminim dhe të cenojnë parimin e barazisë. Ligji shqiptar, duke synuar të adresojë pikërisht këto stereotipe, vepron në linjë me standardin e Strasburgut.

Po kështu, në çështjen **Ünal Tekeli v. Turkey** (16 nëntor 2004), Gjykata vlerësoi se detyrimi ligjor që gruaja e martuar të mbante mbiemrin e bashkëshortit ishte pasojë e një konceptimi tradicional të familjes, ku burri shihej si figura dominuese dhe gruaja si pjesë e statusit të tij juridik. Gjykata konstatoi se ky model pasqyronte stereotipe të papajtueshme me parimin e barazisë (**Ünal Tekeli v. Turkey**, 2004, §§63–67).

Ky precedent tregon se GjEDNJ e konsideron të papranueshme mbështetjen e normave juridike mbi role tradicionale gjinore në familje. Në plan kushtetues, kjo ka rëndësi sepse mbrojtja e familjes nuk mund të kuptohet si ruajtje e pabarazive ose e hierarkive tradicionale brenda saj. Përkundrazi, mbrojtja e familjes duhet të jetë në harmoni me dinjitetin dhe barazinë e anëtarëve të saj.

Në fushën e punësimit, Gjykata ka mbajtur të njëjtën qasje. Në çështjen **Emel Boyraz v. Turkey**, ajo vlerësoi se përjashtimi i një gruaje nga një vend pune mbi bazën e supozimeve se detyra ishte e papërshtatshme për gratë përbënte diskriminim. Gjykata pranoi se aftësitë profesionale nuk mund të vlerësohen mbi bazën e paragjytimeve se disa profesione janë “për burra” dhe disa të tjera “për gra” (**Emel Boyraz v. Turkey**, 2014, §§50–56).

Ky arsyetim është drejtpërdrejt i lidhur me konceptin juridik të gjinisë si kategori që lidhet me ndarjen sociale të roleve dhe pritshmërive. Ligji nr. 64/2025, duke adresuar stereotipet në punësim

dhe në jetën publike, synon të parandalojë pikërisht situata të tilla ku individi vlerësohet jo sipas aftësive, meritës apo zgjedhjeve të veta, por sipas roleve të paracaktuara gjinore.

Në çështjen **Carvalho Pinto de Sousa Morais v. Portugal**, Gjykata shkoi edhe më tej, duke analizuar ndikimin e stereotipeve gjinore në vetë arsyetimin gjyqësor. Ajo konstatoi se vendimmarrja e autoriteteve publike nuk mund të mbështetet në perceptime tradicionale mbi rolin social të grave, mbi vlerën e tyre në varësi të moshës, statusit martesor apo funksioneve familjare. Një qasje e tillë cenon dinjitetin dhe barazinë reale (**Carvalho Pinto de Sousa Morais v. Portugal**, 2017, §§46–54).

Ky vendim është veçanërisht i rëndësishëm për një gjykim kushtetues mbi një ligj për barazinë gjinore. Ai tregon se stereotipet gjinore nuk janë problem vetëm në nivel shoqëror ose mediatik, por mund të depërtojnë edhe në mënyrën se si institucionet arsyetojnë dhe vendosin. Për këtë arsye, një ligj që kërkon integritetin e perspektivës gjinore në politikën publike dhe në veprimtarinë institucionale është mjet i arsyeshëm për të parandaluar vendimmarrje të ndikuara nga paragjykimet të tilla.

Në raport me shtatzëninë dhe amësinë, Gjykata ka theksuar gjithashtu se gratë nuk mund të trajtohen përmes supozimeve se angazhimi i tyre profesional është më pak serioz ose se marrëdhëniet e tyre me tregun e punës është dytësore për shkak të rolit familjar. Në çështjen **Jurčić v. Croatia**, Gjykata konstatoi se paragjykimet mbi funksionin ekonomik të grave shtatzëna përbëjnë formë të diskriminimit gjinor (**Jurčić v. Croatia**, 2021, §§64–71).

Ky precedent tregon se mbrojtja e shtatzënisë dhe amësisë nuk mund të shihet e shkëputur nga barazia gjinore. Edhe pse shtatzënia është realitet biologjik, diskriminimi ndaj grave shtatzëna shpesh buron nga stereotipe sociale për rolin e grave në punë dhe familje. Prandaj, një ligj që njeh dimensionin social të pabarazisë nuk merr në konsideratë biologjinë, por ndihmon në mbrojtjen më efektive të saj në rendin juridik.

Nga këto vendime rezulton një linjë e qartë dhe e qëndrueshme: GjEDNj e konsideron të papajtueshme me Konventën çdo normë, praktikë ose vendimmarrje që mbështetet në supozime tradicionale mbi rolin e grave dhe burrave në familje, punësim ose shoqëri. Gjykata nuk e redukton barazinë në një krahasim formal biologjik, por e trajton atë si çështje të marrëdhënieve shoqërore, roleve të ndërtuara historikisht dhe pengesave që kufizojnë gëzimin efektiv të të drejtave.

Për Gjykatën Kushtetuese shqiptare, ky standard është drejtpërdrejt relevant. Përdorimi i termit “gjini” për të përshkruar role,tribute dhe marrëdhënie sociale ndërmjet grave dhe burrave nuk përbën shmangie nga tradita evropiane e të drejtave të njeriut. Përkundrazi, është në harmoni me vetë mënyrën se si GjEDNj ka interpretuar parimin e mosdiskriminimit dhe të barazisë reale.

- Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian përbën një dimension tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e ligjit nr. 64/2025. Ndryshe nga GjEDNj, e cila e zhvillon analizën e saj mbi bazën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, GJED e ka zhvilluar parimin e barazisë gjinore në kuadër të së drejtës së BE-së, veçanërisht në fushën e punësimit, pagesë së barabartë, mbrojtjes së amësisë, ndarjes së përgjegjësisë familjare dhe masave korrigjuese për nën-përfaqësimin.

Në praktikën e saj, GJED ka treguar se barazia gjinore në të drejtën evropiane nuk është thjesht ndalim formal i diskriminimit, por kërkon analiza të situatave konkrete ku gratë ose burrat përballen me disavantazhe të lidhura me organizimin social të punës, familjes dhe vendimmarrjes. Ky standard është i rëndësishëm për ligjin nr. 64/2025, sepse ai e trajton barazinë gjinore si çështje horizontale të politikave publike, jo vetëm si ndalim të përgjithshëm të diskriminimit.

Një nga shtyllat themelore të jurisprudencës së GJED është mbrojtja e grave nga disavantazhet që lindin në tregun e punës për shkak të shtatzënisë dhe amësisë. Në çështjen **Dekker v Stichting Vormingscentrum voor Jong Volwassenen**, Gjykata vendosi se refuzimi për të punësuar një grua për shkak të shtatzënisë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë mbi bazë seksi (**Çështja C-177/88**, 1990, parag. 10–17).

Ky vendim ka rëndësi themelore sepse pranon se barazia nuk mund të ekzistojë nëse gratë penalizohen profesionalisht për shkak të shtatzënisë. Edhe pse shtatzënia është e lidhur me realitetin biologjik, diskriminimi që lind prej saj në tregun e punës është fenomen juridik dhe social. Ai lidhet me mënyrën se si punëdhënësit dhe institucionet shpërndajnë kostot e riprodhimit, kujdesit dhe përgjegjësiwe familjare. Për rrjedhojë, mbrojtja efektive kërkon më shumë sesa trajtim formal.

Ky standard u thellua në çështjen **Webb v EMO Air Cargo (UK) Ltd**, ku Gjykata theksoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të shtatzënisë nuk mund të justifikohet me arsye organizative ose me nevojën e punëdhënësit për zëvendësim të menjëhershëm (**Çështja C-32/93**, 1994, parag. 19–27). Përmes këtij arsyetimi, GJED pranoi se barazia reale kërkon neutralizimin e mekanizmave që e transferojnë mbi gratë koston sociale të shtatzënisë, lindjes dhe kujdesit familjar.

Këto vendime tregojnë se e drejta evropiane e mbrojtjes biologjike të shtatzënisë, por njëkohësisht analizon pasojat sociale dhe ekonomike që ajo prodhon në një treg pune të ndikuar nga stereotipe gjinore. Ky dallim është i rëndësishëm për shqyrtimin e ligjit nr. 64/2025: njohja e dimensionit social të gjinisë nuk mbron realitetin biologjik, por e bën më të mundur mbrojtjen efektive të grave nga diskriminimi.

Një fushë tjetër ku GJED ka zhvilluar qartë logjikën e barazisë gjinore është ndarja e përgjegjësiwe familjare. Në çështjen **Roca Álvarez v Sesa Start España ETT SA**, Gjykata analizoi një regjim lejeje pune që në praktikë e lidhte kujdesin për fëmijët kryesisht me nënat. Gjykata theksoi se rregulla të tilla rrezikojnë të ruajnë modelin tradicional sipas të cilit kujdesi familjar është përgjegjësi primare e grave, ndërsa burrat mbeten në plan të dytë në jetën familjare (**Çështja C-104/09**, 2010, parag. 27–36).

Ky vendim është veçanërisht i rëndësishëm për ligjin nr. 64/2025, sepse tregon se barazia gjinore nuk është vetëm mbrojtje e grave, por edhe transformim i roleve tradicionale të burrave dhe grave. Ligji shqiptar, duke synuar integrimin gjinor dhe eliminimin e stereotipeve, është në harmoni me këtë qasje: ai kërkon që përgjegjësitë familjare dhe mundësitë profesionale të mos përcaktohen nga role të paracaktuara, por nga barazia dhe liria reale e individëve.

Jurisprudenca e GJED është gjithashtu e rëndësishme në raport me masat korrigjuese për nën-përfaqësimin historik të grave në jetën profesionale dhe publike. Në çështjen **Marschall v Land**

Nordrhein-Westfalen, Gjykata pranoi se, në sektorë ku gratë janë të nën-përfaqësuar, shtetet mund të parashikojnë masa preferenciale në favor të grave, për sa kohë ruhet vlerësimi individual dhe nuk krijohet përparësi automatike (**Çështja C-409/95**, 1997, parag. 28–35).

Në të njëjtën linjë, në çështjen **Badeck and Others**, Gjykata njohu si të pajtueshme me të drejtën e BE-së masa të ndryshme që synonin rritjen e pjesëmarrjes së grave në administratë, përfshirë objektiva për përfaqësim dhe programe trajnimi (**Çështja C-158/97**, 2000, parag. 19–32).

Këto vendime tregojnë se e drejta e Bashkimit Evropian nuk e sheh barazinë si neutralitet formal. Përkundrazi, ajo pranon se kur ekzistojnë pabarazi historike dhe strukturore, shteti mund të ndërmarrë masa të arsyeshme korrigjuese, për sa kohë ato nuk shndërrohen në automatizëm të verbër dhe ruajnë proporcionalitetin. Ky standard është i rëndësishëm për ligjin nr. 64/2025, i cili synon të krijojë mekanizma për barazi efektive, përfaqësim më të balancuar dhe korrigjim të pengesave strukturore.

Nga jurisprudenca e GJED del një qasje e qartë: pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave shpesh lindin nga organizimi social i punës, nga ndarja tradicionale e kujdesit familjar, nga barrierat institucionale dhe nga nën-përfaqësimi në strukturat drejtuese. Për këtë arsye, e drejta e BE-së lejon dhe në disa raste kërkon masa që adresojnë këto pengesa reale. Kjo ka rëndësi të drejtpërdrejtë për shqyrtimin kushtetues të ligjit shqiptar për barazinë gjinore.

Mbi rëndësinë e kësaj jurisprudence për ligjin nr. 64/2025

Jurisprudenca e GjEDNj dhe GJED konvergon në një pikë themelore: barazia gjinore nuk mund të kuptohet vetëm si trajtim formal i njëjtë ndërmjet grave dhe burrave. Ajo kërkon vlerësim të kontekstit shoqëror, të roleve të ndërtuara, të stereotipeve dhe të pengesave që ndikojnë në mundësitë reale të individëve.

Ky standard është drejtpërdrejt i zbatueshëm në rastin e ligjit nr. 64/2025. Ligji përdor termin “gjini” për të përshkruar pikërisht ato role, attribute dhe marrëdhënie sociale që jurisprudenca evropiane i ka identifikuar si burime të pabarazisë. Ai nuk e redukton barazinë në biologji dhe as nuk mohon dallimet biologjike. Ai pranon se, mbi bazën e dallimeve biologjike ose të perceptimeve shoqërore për gratë dhe burrat, shoqëria shpesh ndërton role që mund të prodhojnë disavantazhe.

Nga kjo perspektivë, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me jurisprudencën evropiane për disa arsye.

Së pari, ai synon të luftojë stereotipet gjinore, të cilat GjEDNj i ka konsideruar të papajtueshme me Konventën në çështje si Konstantin Markin, Ünal Tekeli, Emel Boyraz, Carvalho Pinto de Sousa Morais dhe Jurčić.

Së dyti, ai njeh se pabarazitë në punësim, përfaqësim, kujdes familjar dhe vendimmarrje mund të kërkojnë masa aktive, në përputhje me qasjen e GJED në çështjet Dekker, Webb, Roca Álvarez, Marschall dhe Badeck.

Së treti, ai e trajton barazinë gjinore si parim horizontal të politikave publike, gjë që është në përputhje me zhvillimin bashkëkohor të së drejtës evropiane, ku barazia nuk mbetet vetëm ndalim i diskriminimit, por kërkon mekanizma zbatimi, monitorimi dhe korrigjimi.

Së katërti, ligji nuk cenon thelbin e asnjë të drejte themelore, por synon të bëjë efektive të drejtat që Kushtetuta dhe instrumentet evropiane tashmë i garantojnë: dinjitetin, barazinë, mosdiskriminimin, mbrojtjen nga dhuna dhe pjesëmarrjen e barabartë në jetën publike.

Për rrjedhojë, një lexim që do ta kufizonte barazinë vetëm te dallimi biologjik ndërmjet grave dhe burrave do të ishte më i ngushtë se standardi evropian. Ai do të injoronte mënyrën se si gjykatat evropiane kanë trajtuar stereotipet, rolet familjare, diskriminimin ndaj grave shtatzëna, nën-përfaqësimin e grave dhe ndarjen e pabarabartë të përgjegjësiave të kujdesit.

Në përfundim, jurisprudenca evropiane relevante mbështet qartësisht qasjen e ligjit nr. 64/2025. GjEDNJ ka pranuar në mënyrë të përsëritur se stereotipet gjinore janë të papajtueshme me barazinë dhe dinjitetin, dhe se shtetet kanë detyrim të shmangin politika e praktika të bazuara në role tradicionale të grave dhe burrave. GJED, nga ana tjetër, ka zhvilluar një qasje substanciale të barazisë gjinore në punësim, amësi, kujdes familjar dhe përfaqësim, duke pranuar nevojën për masa aktive korrigjuese.

Përdorimi në ligjin nr. 64/2025 i termit “gjini” si nocion që lidhet me role shoqërore, mundësi reale dhe pengesa strukturore ndërmjet grave dhe burrave është plotësisht në përputhje me këtë jurisprudencë. Ligji nuk shmanget nga standardi evropian; përkundrazi, e reflekton atë në rendin juridik shqiptar.

Për këtë arsye, ky **Amicus Curiae** vlerëson se jurisprudenca evropiane duhet ta orientojë Gjykatën Kushtetuese drejt një interpretimi që e sheh ligjin nr. 64/2025 si instrument për realizimin efektiv të barazisë dhe jo si cenim të rendit kushtetues. Nëse rendi juridik kombëtar do të kufizohej vetëm te një kuptim formal ose biologjik i barazisë dhe do të injoronte dimensionin social të pabarazisë, ai do të mbetej pas standardit të zhvilluar nga Gjykata e Strasburgut dhe Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

XI

Argumente kundër pezullimit të zbatimit të ligjit

Kërkesa për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” duhet të vlerësohet me kujdes të veçantë, duke pasur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të kësaj mase në kontrollin kushtetues. Pezullimi i zbatimit të një ligji të miratuar nga Kuvendi nuk është pasojë automatike e paraqitjes së një kërkesë për kontroll kushtetues. Ai përbën një ndërhyrje të përkohshme në efektet e një akti normativ të miratuar nga organi përfaqësues dhe, për këtë arsye, duhet të justifikohet vetëm nëse ekziston rreziku i një dëmi të rëndë, të menjëhershëm dhe të pariparueshëm, i cili nuk mund të shmanget ndryshe deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Në këtë kuptim, standardi që duhet të udhëheqë vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese nuk është thjesht ekzistenca e një mosmarrëveshjeje mbi kushtetutshmërinë e ligjit, por ekzistenca e një rreziku konkret dhe të provuar që zbatimi i ligjit, gjatë kohës së shqyrtimit kushtetues, do të prodhonte pasoja të pakthyeshme për të drejtat, liritë ose rendin kushtetues. Pezullimi nuk mund të mbështetet mbi pretendime abstrakte, mbi kundërshtim terminologjik ose mbi frikë hipotetike për mënyrën se si ligji mund të interpretohet në të ardhmen. Ai kërkon një nivel më të lartë të provueshmërisë dhe urgjencës.

Në rastin konkret, ligji nr. 64/2025 nuk vendos masa ndëshkuese të menjëhershme që do të prodhonin pasoja të pakthyeshme. Ai nuk parashikon dënime penale, nuk vendos ndalime të menjëhershme mbi ushtrimin e të drejtave themelore, nuk ndryshon statusin civil të individëve, nuk ndërhyr në regjimin juridik të familjes, martesës ose prindërisë dhe nuk krijon pasoja të drejtpërdrejta që nuk mund të korrigjohen nëse Gjykata do të arrinte në një përfundim tjetër në vendimin përfundimtar. Përkundrazi, ligji ka karakter kryesisht institucional, programor dhe rregullator, duke vendosur mekanizma për integrimin e barazisë gjinore në politikat publike, për forcimin e përgjegjësiave institucionale dhe për promovimin e komunikimit jo-diskriminues.

Në këto rrethana, nuk rezulton një dëm i rëndë, i menjëhershëm dhe i pariparueshëm që të justifikojë pezullimin. Zbatimi i ligjit, gjatë kohës që Gjykata shqyrton çështjen në themel, nuk krijon pasoja të tilla që do ta bënin të pamundur ose të panevojshëm vendimin përfundimtar të Gjykatës. Përkundrazi, mekanizmat që ligji parashikon janë të natyrës së politikave publike dhe organizimit institucional, të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të plotë në vendimin përfundimtar, pa qenë e nevojshme ndërprerja e menjëhershme e efektit të ligjit.

Nga ana tjetër, pezullimi i ligjit do të prodhonte pasoja reale për interesin publik. Ligji nr. 64/2025 synon të forcojë kuadrin institucional të barazisë gjinore, të parandalojë diskriminimin, të përmirësojë mekanizmat e integritetit gjinor në politikat publike dhe të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me detyrimet ndërkombëtare e evropiane të Shqipërisë. Pezullimi i tij do të vononte zbatimin e këtyre mekanizmave, do të krijonte pasiguri institucionale dhe do të dobësonte përkohësisht kapacitetin e shtetit për të përmbushur detyrimet pozitive në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në këtë drejtim, balanca ndërmjet interesit publik dhe pretendimeve për cenim anon qartësisht në favor të mospezullimit. Interesi publik që lidhet me zbatimin e një ligji për barazinë gjinore është i rëndësishëm dhe i drejtpërdrejtë. Ai lidhet me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, barazisë para ligjit, mosdiskriminimit, mbrojtjes së grave dhe vajzave nga pabarazitë strukturore, si dhe me përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që burojnë nga CEDAW, Konventa e Stambollit dhe standardet evropiane. Këto janë interesa kushtetuese dhe publike që nuk mund të pezullohen lehtësisht mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme ose hipotetike.

Për më tepër, pezullimi i një ligji horizontal në fushën e barazisë gjinore do të krijonte edhe një efekt negativ institucional. Institucionet publike që duhet të ndërmarrin masa për integrimin gjinor, për të dhënat, për raportimin, për komunikimin publik dhe për koordinimin e politikave do të mbeteshin në pasiguri për detyrimet e tyre. Kjo do të dëmtonte parimin e vazhdimësisë institucionale dhe do të dobësonte zbatimin e standardeve të barazisë në administratë dhe në politikat publike.

Gjithashtu, pezullimi do të krijonte boshllëk të panevojshëm në raport me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Nëse shteti ka detyrim të marrë masa aktive për të luftuar diskriminimin, stereotipet gjinore dhe dhunën me bazë gjinore, pezullimi i një ligji që synon pikërisht këtë objektiv do të duhej të justifikohej me arsye shumë të forta kushtetuese. Në mungesë të një dëmi konkret dhe të pariparueshëm, pezullimi do të rrezikonte të prodhonte më shumë dëm për interesin publik sesa zbatimi i përkohshëm i ligjit deri në vendimin përfundimtar.

Në analizën e proporcionalitetit të masës së pezullimit, duhet të merret parasysh edhe natyra e pretendimeve për antikushtetutshmëri. Nëse pretendimet lidhen kryesisht me interpretimin e termave, me mënyrën e leximit të koncepteve të barazisë gjinore ose me shqetësime të përgjithshme mbi ndikimin e ligjit, atëherë ato janë çështje që mund dhe duhet të shqyrtohen në themel. Ato nuk krijojnë vetvetiu urgjencë kushtetuese për pezullim. Pezullimi do të ishte i justifikueshëm vetëm nëse zbatimi i menjëhershëm i ligjit do të sillte pasoja të pakthyeshme, gjë që në rastin konkret nuk evidentohet.

Nga kjo perspektivë, masa e pezullimit do të ishte joproporcionale. Ajo do të ndërpriste efektet e një ligji të miratuar për një qëllim kushtetues legjitim, pa u provuar se zbatimi i tij shkakton dëm të rëndë dhe të pariparueshëm. Në një shtet të së drejtës, prezumimi është se ligjet e miratuara nga Kuvendi zbatohen derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë ndryshe, përveç rasteve kur ekziston një rrezik i qartë, urgjent dhe i pakthyeshëm. Një rrezik i tillë nuk rezulton nga natyra dhe përmbajtja e ligjit nr. 64/2025.

Për këto arsye, ky opinion vlerëson se kërkesa për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 64/2025 nuk duhet pranuar. Zbatimi i ligjit nuk sjell dëm të rëndë, të menjëhershëm dhe të pariparueshëm për të drejtat ose rendin kushtetues, ndërsa pezullimi i tij do të krijonte pasoja negative për interesin publik, për funksionimin institucional dhe për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

PËRFUNDIM

Për arsyet e parashtuara në këtë opinion, *Amicus Curiae* vlerëson se ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe me standardet evropiane në fushën e barazisë, mosdiskriminimit, dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjes efektive të të drejtave themelore.

Nga analiza kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare rezulton se ligji nr. 64/2025 nuk cenon parimin e shtetit të së drejtës, sovranitetin e popullit, dinjitetin njerëzor, barazinë para ligjit, lirinë e shprehjes, lirinë e medias, mbrojtjen e familjes, mbrojtjen e fëmijëve ose rendin kushtetues. Përkundrazi, ai synon të konkretizojë këto vlera kushtetuese përmes një kornize ligjore horizontale që adreson pabarazitë gjinore, stereotipet, diskriminimin dhe pengesat strukturore që kufizojnë gëzimin efektiv të të drejtave nga gratë dhe burrat.

Ligji nuk ndërhyr në statusin civil të personit, nuk ndryshon institutin e martesës, nuk prek regjimin juridik të familjes, nuk modifikon prindërinë, nuk cenon të drejtat e fëmijëve dhe nuk krijon kategori të reja juridike jashtë objektit të tij. Termat që përdor ligji, përfshirë termin “gjini”, duhet të lexohen në funksion të objektit të tij: garantimit të barazisë reale ndërmjet grave dhe burrave, parandalimit të diskriminimit, integritetit të perspektivës gjinore në politikat publike dhe eliminimit të stereotipeve gjinore.

Në planin ndërkombëtar dhe evropian, ligji nr. 64/2025 është në harmoni me detyrimet që burojnë nga CEDAW, Konventa e Stambollit, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe *acquis* i Bashkimit Evropian. Ai nuk përfaqëson devijim nga këto standarde, por një instrument të brendshëm për zbatimin e tyre në rendin juridik shqiptar. Në veçanti, përdorimi i termit “gjinë” dhe masat për luftimin e stereotipeve gjinore janë në përputhje me standardet ndërkombëtare që kërkojnë adresimin e roleve shoqërore, modeleve kulturore dhe pengesave strukturore që prodhojnë pabarazi.

Për këto arsye, **Amicus Curiae** i sugjeron Gjykatës Kushtetuese:

- të rrëzojë kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”;
- të rrëzojë kërkesën për konstatimin e papajtueshmërisë së ligjit nr. 64/2025 me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- të lërë në fuqi ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”;
- nëse e çmon të nevojshme, të sqarojë në arsyetimin e saj se termat e përdorur në ligj interpretohen në mënyrë funksionale dhe sistematike, brenda objektit të ligjit, pra në funksion të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, mosdiskriminimit, eliminimit të stereotipeve gjinore dhe përmbushjes së detyrimeve kushtetuese, ndërkombëtare dhe evropiane të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, Amicus Curiae vlerëson se ligji nr. 64/2025 nuk cenon rendin kushtetues, por e forcon atë, duke i dhënë përmbajtje konkrete parimeve të dinjitetit njerëzor, barazisë, drejtësisë shoqërore dhe mosdiskriminimit. Ai duhet të lexohet si një instrument i nevojshëm për realizimin efektiv të të drejtave themelore në një shoqëri demokratike, pluraliste dhe të orientuar drejt standardeve evropiane.

Përgatitur në cilësinë e Amicus Curiae
Tiranë, 2026

ADENA VANGJELI
DREJTORE EKZEKUTIVE
QENDRA PËR DREJTËSI GJINORE NË SHQIPËRI